



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 2495 Prot.

Tiranë, më 08.09.2025

**RAPORT  
PËR**

**KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK TË PROKURORIVE ME OBJEKT:  
“MBI CAKTIMIN E ÇËSHTJEVE NË PROKURORI”**

Në zbatim të Vendimit nr. 22, datë 15.05.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive me objekt: Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”

Tiranë, më 08/09 /2025

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

### Titulli:

Raporti i inspektimit tematik të Prokurorive me objekt “Mbi caktimin e çështjeve në Prokurori”, në zbatim të vendimit nr. 22, datë 15.05.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

### Data e përgatitjes:

09 / 09 / 2025

### Përgatitur nga:

Znj. Elena Pelushi

Znj. Lindita Ziguri



### Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

z. Artur Metani



Miratoi ☐ Ktheu ☐ Ndryshoi ☐

Dt. 09 / 09 / 2025

## I. Pjesa hyrëse

Me vendimin nr. 22, datë 15.05.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive më objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori””, i ndryshuar me vendimet nr. 22/1 datë 27.11.2024, është vendosur zhvillimi i inspektimit tematik pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, lidhur me caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.

Vendimi për kryerjen e inspektimit është nxjerrë në mbështetje të nenit 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat “ë” dhe “k” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 53 pika 6 e ligjit me nr. 97/2016 “Për organizimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektimi tematik është vendosur të zhvillohet në kuadër të zbatimit të detyrimit të inspektimit periodik të përcaktuar në ligjin me nr. 97/2016 “Për organizimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” të sipërpërmendur. Në nenin 53 pika 6 e ligjit në fjalë parashikohet shprehimisht se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime periodike mbi caktimin e çështjeve”.

Inspektimi tematik është vlerësuar të ketë karakter njohës dhe konstatues lidhur me caktimin e çështjeve në prokurori në raport me respektimin e ligjit organik dhe akteve nënligjore përkatëse në fuqi. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i këtij inspektimi tematik është vlerësuar edhe si një mjet për identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjellje të magjistratëve prokurorë, të cilët në bazë të një dyshimi të arsyeshëm do të justifikonin fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për kryerjen e inspektimit, në mbështetje të pikës 5 të vendimit me nr. 6/2 datë 28.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë ngarkuar inspektorët duke iu caktuar zyrat e prokurorive përkatëse që do të inspektonin. Më konkretisht si më poshtë:

- a) Inspektore znj. Lindita Ziguri për zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe pranë zyrave të Prokurorive të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Lezhë, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Durrës.
- b) Inspektore znj. Elena Pelushi për zyrën e Prokurorisë së Posaçme, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe zyrat e Prokurorive të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Dibër, Kukës.

Inspektorët janë ndihmuar në kryerjen e inspektimit nga ndihmësinpektorët znj. Loreta Jashari, dhe znj. Migena Bako.

Gjithashtu, me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektore znj. Elena Pelushi.

Kryerja e inspektimit është bazuar në vendimin e inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë prokurorive subjekt inspektimi me qëllim administrimin e dokumentacionit, objekt inspektimi”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
  - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga të dy inspektorët;
  - b) Janë hartuar shkresat drejtuar zyrave të prokurorisë objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga të dy inspektorët;
  - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas zyrave të prokurorisë përkatëse dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
  - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
  - b) Vlerësuar se duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar sipas grupeve të inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:
  - a) Hartimi i raporteve të veçanta nga secili prej grupeve të inspektimit për prokuroritë që janë përfshirë në inspektim, sipas një modeli/strukture të njëjtë;
  - b) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

- 4) Faza e katërt: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit”.

Referuar fazave të përcaktuara në vendimin për kryerjen e inspektimit, në fazën e parë të inspektimit mbi bazën e kërkesave për informacion, nga ana e zyrave të prokurorisë janë administruar të dhënat përkatëse. Gjatë fazës të administrimit të dokumentacionit të duhur, nga ana e inspektorëve është proceduar edhe me përsëritje kërkesash për të bërë të mundur marrjen e informacionit të plotë në funksion të realizimit të inspektimit. Dhe në funksion të kësaj, krahas kërkesave të përsëritura, nga ana e inspektorëve është proceduar edhe me

vizita në zyrat përkatëse ku janë mbajtur edhe procesverbalet përkatëse për marrjen e dokumentacionit.

Më konkretisht janë administruar të dhënat nga:

**Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm:**

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë:**

Shkresat me nr. 12005/1 prot., datë 25.06.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/27 prot., datë 26.04.2024; email i datës 30.09.2024, e protokolluar me nr. 1327/43 prot., datë 30.09.2024; email i datës 12.11.2024, 28.01.2025, si dhe është proceduar edhe me një vizitë në zyrën e Prokurorisë Tiranë më datë 23.01.2025;

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier:**

Shkresa me nr. 787/1 prot, datë 04.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/21 prot, datë 07.06.2024.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë**

Shkresa shkresën nr. 2923/1 prot., datë 04.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/22 prot., datë 10.06.2024; email datë 27.09.2024 i regjistruar në ILD me nr. 1327/41, datë 27.09.2024; me shkresën nr. 2923/3 prot., datë 08.11.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/47 prot., datë 14.11.2024; e mail datë 19.11.2024 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, regjistruar në ILD me nr. 1327/50, datë 19.11.2024

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë**

Shkresa nr. 3382 prot, datë 18.09.2024, të regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/39, datë 23.09.2024; nr. 1638 prot., datë 25.02.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 187.2 prot, datë 27.02.2025.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër**

Shkresa nr.4448/1 prot, datë 17.07.2024, të regjistruar pranë ILD-së me nr.1327/35 prot, datë 22.07.2024

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan**



Shkresat me nr.5249/1 prot., datë 04.06.2024 regjistruar në ILD me nr. 1327/19 prot., datë 05.06.2024 dhe shkresa me nr. 10341 datë 03.10.2024 regjistruar në ILD me nr. 1327/45 prot., datë 01.11.2024.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**

Shkresa nr.1840/1 prot, datë 03.06.2024 regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/20 prot., datë 06.06.2024;

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**

Shkresa nr. 2010/1 prot, datë 06.06.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/23 prot, datë 12.06.2024.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër**

Shkresat me nr. 2326 prot., datë 10.09.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/37 prot., datë 12.09.2024 dhe nr. 2743 prot., datë 26.09.2024 e regjistruar në ILD nr. 1327/42 prot., datë 30.09.2024

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës:**

Shkresa nr. 3682/1 prot., datë 12.06.2024, regjistruar në ILD me nr. 1327/25 prot., datë 18.06.2024; shkresa nr. 3682/2 prot., datë 27.09.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/44 prot., datë 02.10.2024.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**

Shkresa nr.8272/1 prot., datë 09.09.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/30 prot., datë 19.09.2024; e-mail më datë 03.02.2025, regjistruar pranë ILD-së me nr. 187/1 prot., datë 03.02.2025.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë**

Shkresa nr. 1059/1 prot., datë 30.07.2024, regjistruar në ILD me nr. 1327/36 prot., datë 01.08.2024, shkresa me nr. 2535 prot., datë 30.10.2024 e regjistruar në ILD me nr.1327/46 prot., datë 04.10.2024.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë**

Shkresa nr. 4999/1 prot., datë 10.06.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/24 prot., datë 13.06.2024; me nr. 4999/2 prot., datë 21.11.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/51 prot.,

datë 25.11.2024 dhe me nr. 4999/3 prot., datë 23.01.2025 regjistruar në ILD me nr. 187 prot., datë 27.01.2025;

### **Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm:**

Shkresat me nr. 1205/1 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/28 prot., datë 05.07.2024; nr. 1205/2 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/32 prot., datë 05.07.2024; 1205/3 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/31 prot., datë 05.07.2024; shkresën nr. 1205/4 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/30 prot., datë 05.07.2024; Shkresat nr. 1205/6 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/33 prot., datë 05.07.2024; nr. 1205/5 prot., datë 04.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/29 prot., datë 05.07.2024; nr. 1205/7 prot., datë 16.07.2024 e regjistruar në ILD me nr. 1327/34 prot., datë 16.07.2024

### **Prokuroria e Përgjithshme**

Shkresa nr. 670/1 prot., datë 25.09.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/40 prot. datë 25.09.2024; shkresa nr. 670/2 prot, datë 14.11.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/48 prot., datë 14.11.2024 nr. 670/3 prot, datë 18.11.2024, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1327/49 prot., datë 18.11.2024

### **Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:**

Shkresa me nr. 7742/1 prot., datë 24.06.2024 regjistruar në zyrën e ILD me nr. 1327/26 prot., datë 25.06.2024, si dhe me email datë 16.07.2024.

**Dokumentacioni si më sipër, ku edhe është mbështetur kryerja e inspektimit përfshin informacion** mbi procedurën e caktimit të çështjeve në secilën zyrë prokurorie; mbi numrin total të çështjeve të regjistruara dhe të shpërndara tek secili prokuror, organizimin e gatishmërisë të lidhur me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe mënyrën e shpërndarjes së çështjeve të cilët mund të jenë me arrest/ndalim, që kërkojnë kryerjen e veprimeve të menjëhershme, të protokolluar pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditëve të festave zyrtare apo edhe të regjistruar kryesisht; aktet nënligjore përkatëse të nxjerrë nga secili prej drejtuesve të zyrave mbi organizimin e prokurorisë në drejtim të caktimit të çështjeve. Çështjet për të cilat është marrë informacioni i trajtuar për kryerjen e inspektimit kanë përfshirë kallëzimet/referimet për kryerjen e veprave penale, procedimet penale të ardhur për shkak kompetence, kërkesat në fazën e ekzekutimeve/në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në kuadër të nenit 59 të K.Pr.Penale, referimet pasurore.

Pas administrimit të të dhënave, në vijim të fazave të përcaktuara të inspektimit është kaluar në përpunimin dhe studimin e tyre, me qëllim mundësimin e hartimit të raporteve individuale të inspektimit.

Inspektimi u fokusua në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore lidhur me procedurën e shpërndarjes së çështjeve, problematikave të hasura apo konstatuar gjatë këtyre procedurave në funksion si të garantimit të paanshmërisë, pavarësisë dhe efikasitetit të punës së prokurorisë për një shpërndarje të drejtë mes prokurorëve, por edhe në funksion të garantimit të transparencës dhe mundësisë së mjaftueshme të verifikimit.

Analiza e të dhënave të administruar në funksion të inspektimit, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë dhe akteve nënligjore përkatëse të dala në zbatim të ligjit organik lidhur me përcaktimin e rregullave të detajuara për procedurën e shpërndarjes së çështjeve, kriteret përkatëse për këtë shpërndarje si dhe mënyrën e monitorimit dhe dokumentimin e tyre.

Gjithashtu në këtë analizë janë përfshirë edhe të dhënat e konstatuar nga inspektimi periodik i kryer në të njëjtat zyra prokurorie për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 për atë sa mund të reflektohej, duke patur në konsideratë se periudha e zbatimit të rekomandimeve të këtij inspektimi ishte jashtë periudhës së inspektimit në fjalë dhe se ky inspektim i fundit ka përfshirë zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm para riorganizimit të tyre<sup>1</sup>. Megjithatë, për konstatimet e rekomandimet përkatëse të inspektimit të mëparshëm, referuar informacionit të përcjellë nga zyrat e prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, evidentohet se për to është bërë e mundur të njihen të gjithë prokurorët si dhe punonjësit administrativ, ndërsa rezulton se nuk ka patur kontestime lidhur me faktet e konstatuara për mënyrën e të proceduarit dhe nevojën për rregullim.

Në funksion të qëllimit të inspektimit, për të dhe parashikimeve të veçanta ligjore/akteve nënligjore për zyrat e prokurorive subjekte të këtij inspektimi, analiza e të dhënave të administruara është bërë duke u proceduar të grupuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe atë të posaçëm. Në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, trajtimi i të dhënave është bërë i grupuar midis prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, dhe për të kaluar në gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga inspektimi i kryer, për zyrat e Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm u konstatua zbatimi si rregull i procedurës së shortimit për shpërndarjen e çështjeve në zyrat ku organika e prokurorëve e bënte të mundur, duke u përdorur shortimi elektronik në zyrat e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore (Juridiksioni i Përgjithshëm) dhe shortimi manual në Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Në mënyrën e dokumentimit të këtij procesi, ashtu sikurse nga konstatimet e inspektimit të mëparshëm me të njëjtën tematikë, u vunë re praktika të ndryshme midis zyrave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallëve të para. Ndërsa për ish zyrat e Prokurorive të Apelit, për shkak të periudhës vetëm 1 muajore për shkak riorganizimi dhe të përkimit të këtij muaji, në periudhën fillim viti, nuk janë evidentuar të dhëna për të konkluduar, në drejtim të praktikave të ndjekur dhe si e tillë,

<sup>1</sup> Riorganizim në kuadër të hartës së re gjyqësore bazuar në VKM nr. 495 datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

edhe referimi do të bëhet vetëm për zyrën e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që ka përfshirë një periudhë prej 11 muaj pas riorganizimit në kuadër të hartës gjyqësore. Procedura e ndjekur për caktimin e çështjeve në prokurori mbështetëj në ligjin organik, në rregullat e përcaktuar në Udhëzimin nr.3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” i ndryshuar, rregulloreve të organizimit të brendshëm të çdo zyre si dhe urdhrave të nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë.

Për zyrën e Prokurorisë së Posaçme, ashtu si edhe nga konstatimet në inspektimin e mëparshëm, u vu re zbatimi si rregull, të proceduarit me shortim për shpërndarjen e çështjeve dhe bazuar në nenin 15 pika 2, shkronja “b” të ligjit me nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Dokumentimi i procesit të shortit ashtu sikurse edhe në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, është bërë me anë të procesverbaleve përkatëse.

Referuar këtyre konstatimeve nga ana e grupit të inspektimit, është konkluduar në rekomandimet përkatëse në drejtim të njohjes për të gjitha zyrat të praktikave më të mira dhe problematikave të konstatuar për shpërndarjen e çështjeve bazuar në parimin e transparencës dhe objektivitetit, si dhe në drejtim të unifikimit të praktikave të shpërndarjes, mënyrës së monitorimit dhe dokumentimit të këtij procesi në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në funksion të mundësive të mjaftueshme të verifikimit.

## II. Objekti i kontrollit dhe gjetjet

Inspektimi në zyrat e prokurorive përfshiu procedurën e caktimit të çështjeve, përgjatë vitit 2023. Në çështjet e evidentuara në prokurorinë e posaçme dhe në prokuroritë e rretheve gjyqësore përfshiheshin kryesisht kallëzimet/referimet penale; procedimet penale të ardhur për kompetencë; referimet pasurore; kërkesat lidhur me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, lidhur me nenin 59 të K.Pr.Penale. Në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në zyrën e Prokurorisë së Apelit në çështjet përfshiheshin njoftimet për përfaqësimin e çështjeve në gjykim lidhur me ankime ndaj vendimeve gjyqësore të themelit, masave të sigurimit, si dhe të tjera të konsideruara si “administrativo – penale/të veçanta”.

Numrin më të madh të çështjeve të cilat i janë nënshtruar procedurës së caktimit, në prokurorinë e posaçme dhe në të gjitha zyrat e prokurorive të rretheve gjyqësore e kanë zënë kallëzimet/referimet penale, që sipas informacionit të përcjellë nga zyrat ka një shpërndarje tek prokurorët në detyrë, si më poshtë:

| Prokuroria           | Numri i kallëzimeve/referimeve penale |
|----------------------|---------------------------------------|
| Prokuroria e Posaçme | 273                                   |
| Berat                | 1131                                  |
| Dibër                | 867                                   |
| Durrës               | 5226                                  |
| Elbasan              | 2211                                  |
| Fier                 | 2241                                  |

|             |       |
|-------------|-------|
| Gjirokastrë | 1095  |
| Korçë       | 2323  |
| Kukës       | 1040  |
| Lezhë       | 1775  |
| Vlorë       | 1956  |
| Sarandë     | 1548  |
| Shkodër     | 1969  |
| Tiranë      | 17144 |

Në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në zyrën e Prokurorisë së Apelit, çështjet paraqiten si më poshtë:

| Prokuroria                | Njoftimet për përfaqësim në gjykim viti 2022 |
|---------------------------|----------------------------------------------|
| Prokuroria e Përgjithshme | 73                                           |
| Apeli                     | 4564                                         |

## **Procedura e ndjekur për caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm**

### **1. Prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm**

#### **1.1. Mënyra e caktimit të çështjeve**

Për shpërndarjen e çështjeve është proceduar me caktimin e prokurorit me short elektronik dhe manual, sipas listës së gatishmërisë dhe nga drejtuesi. Procedura në fjalë paraprihej kryesisht nga regjistrimi i çdo çështje në regjistrat përkatës manual dhe elektronik, pasi më parë është bërë protokollimi në kryesekretari dhe sigluar nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë apo sipas rastit nga zv/drejtuesi/shefi i seksionit, e normuar kjo edhe nga rregulloret e organizimit dhe funksionimit të zyrave të prokurorisë sipas modelit tip të Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm. Në ato zyra ku ka patur seksione apo prokurorë të caktuar për ndjekjen e çështjeve të caktuara me urdhër të drejtuesit, është proceduar me grupimin paraprak të tyre për të kaluar më pas në short. Pas përfundimit të procedurës së caktimit të çështjes, dosja i dorëzohet prokurorit përkatës kundrejt nënshkrimit. E gjithë procedura e shpërndarjes së çështjeve në të gjitha zyrat është organizuar dhe mbikëqyrur nga drejtuesi i zyrës, i ndihmuar nga zv/drejtuesi apo shefi i seksionit sipas rastit dhe nga zyra e regjistratit e specialisti i IT i cili është edhe personi i ngarkuar për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS.

**Shorti elektronik** është përdorur si rregull për shpërndarjen e çështjeve në të gjitha zyrat e prokurorive të rretheve gjyqësore të inspektuara përgjatë gjithë periudhës objekt i këtij inspektimi. Shorti elektronik është kryer nëpërmjet sistemit CAMS për çështje në të cilat janë përfshirë kryesisht kallëzime/referimet e oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprës penale dhe procedimet e ardhur për kompetencë. Në zyrën e prokurorisë Tiranë, Shkodër dhe Gjirokastrë, shorti elektronik ka përfshirë edhe referimet pasurore, ndërsa në

zyrat e tjera, aty ku ka patur<sup>2</sup> për këto lloj çështjesh është proceduar me short manual siç do të evidentohet më poshtë.

Lidhur me shortin elektronik për çështjet e ardhur për kompetencë është konstatuar se ka praktika të ndryshme në zyrat ku ka pasur çështje të tilla. Kështu në zyrën e Tiranë për këto çështje procedohet duke i vendosur një numër 1000.000 në sistem me qëllim shortimi më pas, ndërsa në zyrat e tjera<sup>3</sup> si Berat, Lezhë, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Sarandë, Dibër është proceduar duke e regjistruar me numër kallëzimi si edhe për çështjet e tjera të këtij lloji dhe duke proceduar më tej me shortin për caktimin e një prokurori.

Lidhur me shortin elektronik për çështjet e llojit referime pasurore është konstatuar se nuk është ndjekur e njëjta praktikë në zyrat e prokurorive të evidentuara. Kështu në Tiranë është proceduar duke i vendosur një numër mbi 100.000 në sistem me qëllim shortimi më pas, ndërsa në zyrat Shkodër dhe Gjirokastrë është proceduar duke e regjistruar me numër kallëzimi si edhe për çështjet e tjera të këtij lloji dhe duke u proceduar më tej me shortin.

Për mënyrën e të proceduarit me short elektronik në mënyrë të veçantë në zyrën e prokurorisë Tiranë, për çështjet e ardhur për kompetencë dhe ato të referimit pasuror, sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm, është arsyetuar e lidhur me sistemin CAMS, me qëllim për t'u mos u ngatërruar me numrin e kallëzimeve.

**Shorti manual** është përdorur në zyrat e prokurorive Elbasan, Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Kukës. Kjo procedurë, referuar informacionit të përcjellë, është zhvilluar mbështetur në organizimin për llojet e çështjeve apo të vetë organizimit të seksioneve. Më konkretisht:

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Shkodër, është konstatuar se përdoret kryesisht për rastin e njoftimeve për përfaqësimet në gjykim të kërkesave bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale. Për këtë mënyrë të proceduari është shpjeguar mungesa e një rubrike në sistemin CAMS apo të një metode tjetër të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme për shortimin elektronikisht të tyre.

Gjithashtu, shortimi manual në zyrën Shkodër është evidentuar edhe lidhur me një rast të një materiali hetimor të ardhur për kompetencë. Ky rast ishte një nga 9 materialet hetimore të ardhur për kompetencë në zyrë, që nuk është proceduar me short elektronik nga 93 materialet hetimore të ardhur gjithsej në këtë zyrë prokurorie. Nga këto rezulton se për 4 është proceduar me kalimin prokurorit të gatshëm, për 4 i janë kaluar prokurorit që kishte një procedim të lidhur dhe 1 me anë të shorti manual që është rasti i sipërpërmendur dhe për të cilin, për shkak të mungesës vlerësohet vijimi i verifikimeve të mëtejshme.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Elbasan, është konstatuar se përdoret kryesisht për kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë/përfaqësim në gjykimin e

<sup>2</sup> Në zyrën Shkodër, Kukës nuk ka patur referime pasurore

<sup>3</sup> Në zyrën Kukës, Shkodër dhe Korçë nuk evidentohen të dhëna për çështje të ardhur për kompetencë.

kërkesave bazuar në nenin 59 të K.Pr.Penale, dhe ato të referimeve pasurore. Për këtë mënyrë të proceduari, është mbështetur në të njëjtën arsyetim ashtu sikurse në inspektimin e periudhës së mëparshme, e lidhur me sistemin CAMS, i cili nuk parashikon rubrikë për të shortuar. Shpërndarja manualisht e këtyre çështjeve bëhet midis prokurorëve të seksionit përkatës të përcaktuar mbi bazën e urdhrit të drejtuesit. Gjithashtu me këtë mënyrë shortimi manual, për periudhën objekt i këtij inspektimi është proceduar edhe për çështjet e lidhur me procesin zgjedhor referuar urdhërit të zv/drejtuesit të zyrës “Mbi organizimin e shërbimit të gatishmërisë së përforsuar të prokurorëve, oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për periudhën zgjedhore nga 14.04.2023 – 19.05.2023”, duke u shpërndarë midis prokurorëve përkatës të seksionit të ngritur për këtë qëllim.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Korçë, vihet re i njëjti konstatim si edhe në inspektimin e kaluar. Kjo mënyrë e të proceduari është bërë lidhur me referimet pasurore, për të cilën nuk ka një akt të veçantë nga drejtuesi i prokurorisë, por që janë shpërndarë ndërmjet prokurorëve të seksionit të posaçëm. Këta prokurorë sipas shpjegimeve janë ngarkuar me hetimin e veprave penale në fushën Ekonomike-Financiare dhe kundër narkotikëve dhe seksioni në vitin 2023 ka qenë i përbërë nga 3 prokurorë. Shpërndarja me short manual i referimeve pasurore është bërë midis prokurorëve të seksionit të posaçëm, duke u mbajtur procesverbalet përkatëse.

Gjithashtu gjatë këtij inspektimi, është sqaruar se kjo mënyrë të proceduari është aplikuar edhe për shpërndarjen e letërporosive nga jashtë. Këto materiale rezultojnë se u janë shpërndarë kryesisht prokurorëve të seksionit të përgjithshëm, ndërsa për dy materiale është proceduar me caktimin prokurorit të seksionit të posaçëm. Sipas informacionit të marrë nga zyra Korçë, prokurorët e seksionit të përgjithshëm kanë trajtuar materiale në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe gjithashtu edhe të të miturve.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Fier, kjo mënyrë e të proceduarit është kryer lidhur me referimet pasurore/kërkesat për ekzekutimin e vendimeve penale/kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë (me përjashtim të kërkesave për ekstradim me arrest provizor që i kalojnë prokurorit të gatshëm), përfaqësimet në gjykimin e kërkesave bazuar në nenin 59 të K. Pr. Penale. Materialet e bëra hyrje në Prokurori, pasi protokolloheshin i kalonin drejtuesit të prokurorisë dhe më tej drejtuesve të seksioneve të posaçëm dhe të ekzekutimeve, të cilët organizonin shortin për shpërndarjen e tyre. Në lidhje me materialet/praktikat që lidhen me fazën e ekzekutimeve, zakonisht i kalonin drejtpërdrejt për drejtuesit të seksionit të ekzekutimeve që organizonte shpërndarjen e tyre me short mes prokurorëve të seksionit.

Në zyrën Fier, është konstatuar se nuk ka patur gjatë gjithë periudhës së inspektimit organizim të prokurorëve me seksione. Kështu për 3 muaj e parë të vitit, zyra ka qenë e organizuar në tre seksione, dy nga të cilët seksioni i posaçëm dhe i ekzekutimit të vendimeve penale të përbërë nga 2 prokurorë, në vazhdim për 3 muaj nuk ka patur organizim seksionesh, në korrik të vitit 2023 është organizuar vetëm 1 seksion i posaçëm

i përbërë nga 3 prokurorë dhe në vijim nga tetori 2023 dhe në përfundim të vitit janë shtuar edhe 2 seksione të tjerë ndër të cilët edhe ai i ekzekutimeve i përbërë nga 3 prokurorë.

Gjithashtu kjo mënyrë e të proceduarit është bërë edhe me rastin e rifillimit të hetimeve pasi ishte vendosur pezullimi/pushimi i hetimeve dhe kur prokurori që kishte vendosur nuk ushtronte më funksionin e prokurorit në këtë zyrë. Për procedurën në fjalë janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Vlorë, kjo mënyrë e të proceduarit është bërë lidhur me shpërndarjen e referimeve pasurore midis dy prokurorëve të seksionit përkatës për këtë kategori çështjesh.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Lezhë, kjo mënyrë e të proceduarit është bërë gjatë gjithë periudhës lidhur referimet pasurore. Për këtë mënyrë të proceduarit nuk ka një akt të shkruar paraprak nga drejtuesi i prokurorisë. Ndërsa është evidentuar përdorimi i këtij shorti edhe për shpërndarjen e çështjeve me të mitur midis dy prokuroreve të caktuara për një periudhë 2 mujore nga ana e drejtuesit me urdhër të veçantë. Shpërndarja manuale e këtyre çështjeve është shoqëruar me mbajtjen e procesverbaleve përkatëse.

Lidhur me shortin manual në rastin e zyrës Durrës, kjo mënyrë e të proceduarit është bërë lidhur me referimet pasurore, si dhe me çështjet në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja/fushën e ekzekutimeve/neni 59 i K.Pr.Penal, përveç rasteve me arrest të përkohshëm të cilat për shkak të natyrës së ngutshme janë caktuar sipas grafikut të gatishmërisë. Referimet pasurore janë shpërndarë ndërmjet prokurorëve të seksionit të posaçëm i ngritur mbi bazën e urdhrit të drejtuesit, ku është parashikuar edhe ndjekja e këtyre lloj çështjeve. Numri i prokurorëve në këtë seksion ka qenë i ndryshueshëm përgjatë periudhës së inspektimit, por që nuk ka rënë nën numrin 3. Çështjet e tjera të sipërpërmendura janë shpërndarë ndërmjet 4<sup>4</sup> prokurorëve të seksionit përkatës të ekzekutimeve i ngritur edhe ky mbi bazën e urdhrit të drejtuesit, ku është parashikuar edhe ndjekja e këtyre lloj çështjeve.

Gjithashtu me këtë mënyrë është proceduar edhe për 2 nga 76 materialet e dërguar për kompetencë, për pjesën tjetër të të cilave është proceduar me short elektronik. Sipas informacionit të marrë lidhur me këtë mënyrë për këto 2 materiale është për shkak të problematikës të sistemit elektronik të mos shortimit për herë të dytë të një materiali të regjistruar më parë. E njëjta problematikë është shfaqur edhe për çështjet e caktuar ndër prokurorët e Seksionit të hetimit të veprave penale të kryer nga të mitur dhe Ekzekutimin e vendimeve penale, ku evidentohet ndarja me short manual të materialeve kallëzuese me të mitura të shortuara edhe më parë nëpërmjet sistemit CAMS në seksione të tjera.

---

<sup>4</sup> 1 prokuror ka ushtruar detyrën duke filluar nga data 01.05.2023



Lidhur me shortin manual në zyrën Sarandë, evidentohet të jetë realizuar kur nuk është bërë e mundur për shkak të numrit më të vogël se 3 të prokurorëve ndërmjet të cilëve do të duhej të bëhej shortimi elektronik.

Lidhur me shortin manual në zyrën Kukës, evidentohet të jetë realizuar lidhur me çështjet e pezulluara me rastin e rifillimit dhe kur prokurorët që kanë vendosur pezullimin nuk ushtrojnë funksionin e prokurorit në këtë zyrë prokurorie. E njëjta gjë, edhe lidhur me rastet e kthimit të akteve nga gjykata dhe kur prokurorët përkatës nuk janë në detyrë.

Shpërndarja manuale e këtyre çështjeve është shoqëruar me mbajtjen e procesverbaleve përkatëse.

**Shpërndarja e çështjeve sipas listës së gatishmërisë** tek prokurori i gatshëm, është përdorur në të gjitha zyrat objekt inspektimi, kryesisht për çështje me të arrestuar në flagrancë/ndaluar me iniciativë, që kërkonin veprime të menjëhershme të cilat mund të ishin referuar edhe jashtë orarit zyrtar, ditëve të pushimit apo në festa zyrtare. Në këto çështje të shpërndara sipas listës së gatishmërisë janë përfshirë kallëzimet/referimet e oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprës penale, referimet pasurore, çështjet lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja me qëllim ekstradimin e shtetasve apo njohjen e vendimeve gjyqësore të huaja, si dhe ato lidhur me letërporositë.

Gjithashtu ka pasur edhe zyra prokurorie si Gjirokastrë, Vlorë, Lezhë ku është proceduar me shpërndarjen e çështjeve të tilla edhe pa arrest apo që kërkonin veprime të menjëhershme të referuar në periudhën e gushtit të cilat janë shpërndarë sipas listës së gatishmërisë.

Lidhur me këtë mënyrë të proceduarit, nga zyrën e prokurorisë Gjirokastrë është proceduar me urdhër të veçantë nr. 3, datë 26.07.2023 “ Për shpërndarjen e çështjeve sipas grafikut të gatishmërisë për muajin gusht”, sipas të cilit procedurat e shortit të zakonshëm do të pezullohen dhe prokurorit të gatshëm, përveç çështjeve me arrestime ose ndalime do t’i shortohen manualisht edhe kallëzimet ose referimet e tjera të zakonshme.

Lidhur me sa më sipër, shpërndarjen e çështjeve sipas listës së gatishmërisë, janë konstatuar edhe raste si në zyrën e prokurorisë Korçë, ku për çështjet (kallëzime/referime) me të mitur dhe pa masë sigurimi, deri në datën 05.10.2023, i janë caktuar prokurorit të gatshëm të seksionit për të mitur duke mbajtur procesverbalin përkatës dhe pas kësaj date, këto çështje janë hedhur me anë të shortit elektronik brenda seksionit për shkak të plotësimit të tij me 3 prokurorë.

**Lidhur me çështjet (kallëzime/referime penale) të regjistruara kryesisht** nga prokurori në të gjitha zyrat e prokurorisë të inspektuara është ndjekur i njëjti rregullim, që ato janë ndjekur më tej nga i njëjti prokuror që ka referuar regjistrimin e çështjes.

**Lidhur me shpërndarjen e çështjeve (kallëzime/referime penale) për të cilat konstatohet** para se të procedohet me short elektronik, **se është i njëjti fakt/ka lidhje me faktin për cilën ka një kallëzim të regjistruar më parë dhe caktuar një prokurori**, në zyrat e

prokurorive ku është konstatuar Shkodër, Korçë, Sarandë, Elbasan, Kukës , Gjirokastrë dhe Tiranë është ndjekur i njëjti rregullim, caktimi i tyre të njëjtit prokuror. Ky rregullim është arsyetuar me faktin e shmangies së disa hetimeve njëkohësisht për të njëjtin fakt.

**Shpërndarja e çështjeve për një grup çështjesh një prokurori të ngarkuar që më parë me urdhër të Drejtuesit,** është ndjekur kryesisht në zyrat e prokurorive të cilat nuk kishin seksione të veçanta për grup veprash duke caktuar me urdhër një prokuror për ndjekjen e tyre. Përmendim këtu:

- zyrat e prokurorisë Berat, Lezhë, Gjirokastrë, Korçë, ku për çështjet lidhur me veprat penale në fushën e hetimit financiar dhe parandalimit të pastrimit të parave, të hetimeve pasurore, si dhe lidhur me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me Jashtë me urdhër të drejtuesit i janë kaluar prokurorit që ishte caktuar më parë për ndjekjen e tyre.

-zyrën e prokurorisë Shkodër, ku ashtu sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm, çështjet lidhur me shqyrtimin e letërporosive, ekstradimeve, ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë dhe kërkesat e tjera në lidhje me të dënuarin të cilat i kanë kaluar prokurorit të ekzekutimeve që ka qenë një i vetëm i përcaktuar sipas urdhrit të mëparshëm të drejtuesit.

-zyrën e prokurorisë Sarandë ku çështjet lidhur me të miturit, me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të përfaqësimit në gjykatë lidhur me gjykimin e kërkesave të viktimës akuzuese sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, si dhe për ndjekjen e çështjeve kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit. krimeve financiare dhe hetimeve pasurore i kanë kaluar një prokurori që ka qenë një i vetëm i përcaktuar sipas urdhrit të mëparshëm të drejtuesit.

-zyrat e prokurorive Lezhë dhe Kukës ku për çështjet në fushën e ekzekutimeve dhe me persona të mitur i janë kaluar prokurorit që me urdhër të drejtuesit ishte caktuar me ndjekjen e këtyre çështjeve. Në këto zyra ka rezultuar se me urdhër të drejtuesit në kuadër të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë është caktuar një prokuror që do të merrej me ndjekjen e këtyre lloj çështjesh.

Për zyrën Lezhë kjo periudhë ka vazhduar deri në tetor 2023, kohë kur me urdhër të veçantë janë caktuar dy prokurorë për të trajtuar çështjet me të mitur, të cilëve u caktoheshin këto çështje në mënyrë të barabartë.

- zyrën e prokurorisë Dibër, për një periudhë kohe referuar urdhrit të drejtuesit, për grupveprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare është caktuar një prokuror për ndjekjen e tyre dhe për rrjedhojë të gjitha veprat penale në këtë fushë në momentin e regjistrimit kalonin për ndjekje tek ky prokuror.

**Shpërndarja e çështjeve të regjistruar mbi bazën e urdhërit të gjykatës<sup>5</sup>, apo të rifilluara referuar vendimeve të pezullimit/pushimit të hetimeve, në ato zyra ku edhe ka të evidentuar raste të tilla,** është bërë duke ia kaluar atij prokurori që ka vendosur më parë me vendim i cili është bërë objekt shqyrtimi nga gjykata dhe urdhërimi prej kësaj të fundit për të filluar/vazhduar hetimet. Kjo procedurë është ndjekur përsa kohë prokurori vazhdonte të ushtronte detyrën në atë zyrë, dhe nëse jo procedohej me zëvendësim.

Lidhur me këtë mënyrë të të proceduari nga zyra Shkodër, veçanërisht është shpjeguar përdorimi i shortit manual me arsyetimin se *“nuk ka një rubrikë apo një mënyrë për të shortuar për të dytën herë një kallëzim penal në sistemin CAMS, por i njëjti numër kallëzimi nuk mund të shortohet për të dytën herë në atë viti kalendarik.”*.

Gjithashtu, në zyrën Gjirokastër konstatohet caktimi nga drejtuesi i një prokurori pa u proceduar me short, për ndjekje i dy çështjeve për të cilat është urdhëruar regjistrimi nga ana e gjykatës, mbështetur në arsyetimin si prokurori me ngarkesën më të ulët.

**Shpërndarja e çështjeve me caktim nga drejtuesi është hasur si procedurë në disa zyra për çështje të ndryshme bazuar në arsyetimin e mungesës së prokurorëve efektivë për ushtrimin e detyrës dhe në kuadër të mbarëvajtjes së punës.**

Në zyrën Lezhë rezulton se çështje të caktuara nga drejtuesi kanë përfshirë kallëzime/referime të oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprës penale, kryesisht që kërkonin kryerjen e veprimeve të menjëhershme. Referuar këtyre çështjeve, rezultojnë se 32 kallëzime janë marrë nga drejtuesi i zyrës i cili nuk rezulton të jetë në listën e gatishmërisë, dhe në 5 raste këto i janë caktuar nga drejtuesi i zyrës një prokurori i cili nuk rezulton të jetë i planifikuar në listën e gatishmërisë. Drejtuesi i zyrës rezulton të ketë marrë një numër prej 36 kallëzime për periudhën objekt inspektimi dhe nuk rezulton të jetë i përfshirë në shortin elektronik. Lidhur me këtë mënyrë të të proceduarit, nga ana e drejtuesit të prokurorisë është shpjeguar se *“mënyra primare e ndarjes së këtyre çështjeve ka qenë ndarja e tyre me short elektronik, por duke qenë se sistemi CAMS që shërben për hedhjen e shorteve elektronike, gjatë shortit i përfshin të gjithë prokurorët që janë të regjistruar (për prokurorinë e Lezhës gjithë prokurorët e emëruar përveç drejtuesit), duke mos marrë parasysh arsye të tjera objektive që mund të jenë shkak për përjashtimin e prokurorëve, siç është kryesisht mungesa e prokurorit në ditën e hedhjes së shortit dhe pamundësia e kryerjes së veprimeve të menjëhershme, por pa lënë mënjane dhe ngarkesën e prokurorëve arsye tjetër kjo që mund të sjellë pamundësi për kryerjen e veprimeve të menjëhershme, në kohën e duhur. Sistemi CAMS menaxhohet nga Drejtoria e IT në Prokurorinë e Përgjithshme dhe heqja e prokurorëve nga shorti bëhet me procesverbal drejtuar kësaj drejtorie duke marrë një kohë të konsiderueshme komunikimi ndër-institucional. Arsyet e lartpërmendura kanë vënë para përgjegjësisë Drejtuesin e Prokurorisë ku për një menaxhim sa më të mirë të këtyre çështjeve që parësore të jetë fleksibiliteti dhe realizimi i funksionit të prokurorisë në përputhje me ligjin të gjejë zgjidhje që të japin rezultat të menjëhershëm siç e kërkojnë dhe këto çështje. Një ndër zgjidhjet që*

<sup>5</sup> Në zyrat Berat, Dibër nuk ka patur raste të tilla

është përdorur ka qenë shpërndarja e tyre sipas grafikut të gatishmërisë, por ka patur dhe raste kur në pamundësi objektive të prokurorit të planëzuar në gatishmëri, siç mund të jenë psh: për shkak të një sëmundjeje, për shkak të marrjes së lejes, për shkaqe familjare, ose për shkak të ngarkesës konkrete të menjëhershme me çështje në kohën e gatishmërisë, të cilat bëjnë që prokurori i gatshëm të mos ketë mundësi objektive për t'iu përgjigjur me fleksibilitet vetë gatishmërisë dhe veprimeve të menjëhershme me afate të shpejta të saj, si dhe për çdo shkak tjetër objektiv të analizuara për çdo rast. Drejtuesi i Prokurorisë duke marrë në konsideratë ankesën, si zgjidhje primare ka marrë vetë përsipër zgjidhjen e çështjeve me veprime të menjëhershme dhe për rrjedhojë ndjekjen e hetimit në vazhdim, por nuk përjashtohet dhe rasti i pamundësisë së drejtuesit për ndjekjen e veprimeve të menjëhershme nga ana e tij dhe si zgjidhje është konsideruar në caktimin e prokurorit që ka patur ngarkesën më të ulët të momentit (si psh numrin më të vogël të gjyqeve ditën në fjalë, etj) ”.

Në zyrën Korçë rezulton se çështje të caktuar nga drejtuesi kanë përfshirë kallëzime/referime të oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprës penale. Nga këto çështje në numër 4, dy i janë shpërndarë një prokurori jo sipas listës së gatishmërisë dhe 2 çështje janë marrë për t'u ndjekur nga vetë drejtuesi i përfshirë në listën e gatishmërisë me periudha të caktuara. Për këto çështje nuk është evidentuar të ketë një arsye lidhur me këtë caktim.

Në zyrën Gjirokastrë rezulton se çështjet me të dëmtuar akuzues, për veprat penale të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, në këtë zyrë prokurorie ato i kalonin për përfaqësimin në gjykim një prokurori të caktuar nga drejtuesi i prokurorisë. Gjithashtu nga drejtuesi i prokurorisë vihet re caktimi i një kallëzimi për ndjekje një prokurori, mbështetur në faktin e eksperiencës më të madhe, natyrës sekrete dhe institucionit nga vinte. Po kështu konstatohet caktimi nga drejtuesi i një prokurori, për ndjekje i dy çështjeve për të cilat është urdhëruar regjistrimi nga ana e gjykatës, mbështetur në arsyetimin si prokurori me ngarkesën më të ulët.

Në zyrën Shkodër rezultojnë çështje të caktuar nga drejtuesi, të cilat përfshijnë kategoritë e çështjeve – referime/kallëzime dhe kërkesa në kuadër të nenit 59 të K.Pr.Penal. Për kategorinë e çështjeve referime/kallëzime evidentohet edhe caktimi i një materiali në mungesë të një prokurori të gatshëm, një prokurori tjetër. Për këtë të fundit nuk ka një dokumentacion justifikues, ndonëse në informacionin e dërguar në kuadër të këtij inspektimi, informohet se “Në rastet kur prokurori për arsye objektive të komunikuar atë ditë që ndodh ngjarja, nuk mund të realizojë gatishmërinë për atë material apo ngjarje, me anë të shortit manual ose në raport me ngarkesën e prokurorëve dhe llojin e veprës penale, apo nëse ka të mitur, çështja i kalon prokurorit tjetër. Në rast pamundësi për të realizuar ditët e gatishmërisë, prokurori njofton Drejtuesin e Prokurorisë dhe bëhet ndryshimi i grafikut të gatishmërisë”.

Në zyrën Dibër rezultojnë çështje të caktuar nga drejtuesi, të cilat përfshijnë çështjet e referimeve/procedimeve pasurore, kërkesave në fazën e ekzekutimeve, çështjeve me përfaqësim në gjykatë lidhur me kërkesat bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale,

kërkesave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë. Lidhur me këtë mënyrë të proceduari për referimet pasurore, është informuar se ato deri në datën 01.09.2023 i janë shpërndarë me siglim nga drejtuesi, për shkak se nuk mund të hidhen në short elektronik, pasi sistemi CAMS nuk ka opsion të emërtuar për këtë kategori çështjesh, ndërsa në datën 01.09.2023 mbi bazën e urdhrat të drejtuesit është rregulluar se për materialet e grupveprave penal kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare është caktuar një prokuror për ndjekjen e tyre dhe për rrjedhojë të gjitha veprat penale në këtë fushë në momentin e regjistrimit do të kalonin për ndjekje tek ky prokuror. Ndërsa në lidhje me rastet e tjera, nuk evidentohen të dhëna të qarta duke pasur në konsideratë faktin se është proceduar në këtë mënyrë nga ish drejtuesit referuar periudhës objekt inspektimi dhe të cilët në kohën e administrimit të të dhënave nuk kishin statusin e magjistratit.

Në zyrën Berat rezultojnë çështje të caktuar nga drejtuesi, lidhur me çështjet – referim pasuror, të cilat i kanë kaluar direkt prokurorit që është caktuar për hetimin e veprave penale për “Pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, dhe që në këtë zyrë ka qenë vetë drejtuesi i prokurorisë. Çështje të tjera të caktuar nga drejtuesi është konstatuar edhe ato lidhur me të mitur, ndërkohë që kishte një seksion të përbërë nga tre prokurorë dhe për të cilat nuk ka arsye për këtë mënyrë të proceduari. Kështu rezultojnë 21 materiale për të mitur të cilat i janë caktuar prokurorit për të mitur me shënimin nga drejtuesi, ndërsa ky i fundit t’i ketë caktuar vetes, për ndjekje një numër prej 68 kallëzime të regjistruar në periudhën objekt inspektimi. Gjithashtu lidhur me përfaqësimin e prokurorisë në gjykatë, në çështjet e regjistruara me kërkesë të të dëmtuarit akuzues, bazuar në nenin 59 të K.Pr.Penale, apo dhe kërkesa të tjera civile si “Heqje e zotësisë për të vepruar”, etj, gjatë vitit 2023 është ndjekur një procedurë mirëkuptimi nga prokurorët për pjesëmarrjen nëpër këto seanca të prokurorit me ngarkesën më të ulët të gjyqeve për ditën respektive. Nuk është mbajtur një e dhënë e saktë për këto lloj çështjesh.

Në zyrën Tiranë rezultojnë çështje të marra nga vetë drejtuesi dhe caktuar drejtuesve të seksioneve të cilët nuk kanë qenë pjesë e shortit elektronik me qëllim plotësimin e tyre në ngarkesë, si dhe u janë caktuar çështje për shkak të dinamikës së hetimit, kompleksitetit dhe veprimeve urgjente hetimore janë vlerësuar nga drejtuesi i prokurorisë që duhen të hetohen nga drejtuesit e seksioneve përkatëse, si edhe në rastet e krijimit të grupeve hetimore. Si të tilla rezultojnë të jenë rreth 57 kallëzime, nga të cilat 26 i përkasin drejtuesit. Referuar këtyre kallëzime të fundit, për dy prej tyre rezultojnë të jenë me grup hetimor me një prokuror tjetër i cili në një rast rezulton të jetë i gatshëm në ditën e regjistrimit të kallëzimit.

Gjithashtu në të njëjtën zyrë prokurorie, rezultojnë çështje të caktuar nga drejtuesi i seksionit përkatës, të cilat përfshinin ato të lidhur me kërkesat në fushën e ekzekutimeve të vendimeve penale, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe në kuadër të nenit 59 të K.Pr.Penale. Sipas informacionit të marrë nga kjo zyrë, kjo mënyrë e të proceduarit është arsyetuar me faktin se sistemi elektronik nuk është funksional dhe se gjithashtu një pjesë e praktikave që hyjnë, trajtohen nga i njëjti prokuror. Për këto materiale në përgjithësi është ndjekur procedura e shpërndarjes nëpërmjet siglimit nga drejtuesi i Seksionit dhe se për

këtë nuk mbahen procesverbale, për shkak të dinamikës dhe volumit të punës. Pasqyrimi i shpërndarjes bëhet me libër dorëzimi të brendshëm.

Në zyrën Elbasan caktimi nga drejtuesi është evidentuar në 1 rast kur prokurori i gatshëm ka qenë me probleme shëndetësore dhe për këtë shkak është ngarkuar për hetimin zv.drejtuesi i zyrës, si dhe në 1 rast tjetër kur për çështjen është caktuar grup hetimor.

Në zyrën Sarandë, si mënyrë caktimi për çështjet, e cilësuar nga vetë drejtuesi për çështjet e marra vetë, janë edhe ato në numër 22 të vlerësuar sipas tij nga natyra e kallëzimit dhe me qëllim lehtësimin e ngarkesës së prokurorëve. Gjithashtu në informacionin e sjellë nga vetë drejtuesi është edhe marrja përsipër e hetimeve, e cilësuar si e tillë nga drejtuesi për shkaqe pamundësie, shëndetësore, të prokurorit të gatshëm, e evidentuar kjo në 1 rast; apo për shkak të ardhjes së 3 prokurorëve rinj, të cilëve rezulton se në një datë të caktuar u janë shpërndarë 6 kallëzime të regjistruara, për secilin nga dy materiale kallëzuese. Një mënyrë tjetër e evidentuar e marrjes përsipër të hetimeve nga drejtuesi i prokurorisë është kur sipas tij, në 1 rast *“nuk ishte gjetur bashkëpunimi i prokurores së gatshme për kryerjen e veprimeve me metoda speciale të hetimit, për shkak të delikatesës së çështjes dhe përfshirjes në ngjarje të punonjësve të policisë, duke patur në konsideratë edhe ngarkesën e prokurores”* dhe 1 në një rast tjetër për shkak *“të mosveprimit të prokurorit të gatshëm”*.

Në zyrën Kukës, referuar rasteve përgjatë periudhës së inspektimit, evidentohet caktimi nga drejtuesi i prokurorit i prokurorit përkatës për përfaqësimin e prokurorisë lidhur me çështjet me të dëmtuar akuzues, sipas nenit 59 të K.Pr.Penale.

**Referuar numrit të kallëzimeve/referimeve të veprave penale si numri më i madh i çështjeve të evidentuara për të cilat është proceduar me shpërndarjen e çështjeve në prokurori, rezulton se pjesa më e madhe e tyre i është nënshtruar shortit elektronik, me një shpërndarje si më poshtë:**

| Nr. | Prokuroria Shk. Parë Juridiksioni Përgjith. | Kallëzimet penale Regj.Total | Short Elektronik |
|-----|---------------------------------------------|------------------------------|------------------|
| 1   | Kukës                                       | 1040                         | 919              |
| 2   | Lezhë                                       | 1775                         | 1188             |
| 3   | Sarandë                                     | 1548                         | 1199             |
| 4   | Vlorë                                       | 1956                         | 1227             |
| 5   | Durrës                                      | 5226                         | 4465             |
| 6   | Elbasan                                     | 2211                         | 1739             |
| 7   | Dibër                                       | 894                          | 609              |
| 8   | Berat                                       | 1131                         | 777              |
| 9   | Fier                                        | 2241                         | 1176             |
| 10  | Gjirokastrë                                 | 1095                         | 808              |
| 11  | Korçë                                       | 2323                         | 1868             |
| 12  | Shkodër                                     | 1969                         | 1587             |
| 13  | Tiranë                                      | 17144                        | 14970            |

## 1.2. Raporti i shpërndarjes së çështjeve midis prokurorëve

Shpërndarja e çështjeve midis prokurorëve në drejtim të një raporti të drejtë, nëpërmjet procedurës së sipërpërmendur dhe në konsideratat e të gjithë periudhës objekt inspektimi, ashtu siç ka rezultuar nga inspektimi i mëparshëm, është kushtëzuar dukshëm në shumë zyra të inspektuara nga lëvizjet e prokurorëve që mund të kenë qenë transferime/pezullim/shkarkim si dhe emëtime të reja. Ndodhur në këto kushte drejtuesit e zyrave Lezhë, Shkodër, Berat, Dibër, Kukës, Sarandë, janë përfshirë duke zëvendësuar prokurorët në listat e gatishmërisë apo futjen e tyre në short duke marrë edhe ngarkesë të konsiderueshme në raport me prokurorët e tjerë.

Në disa zyra të tjera si Tirana, Fier, Korçë, Vlorë, Durrës, Shkodër është konstatuar se të dhënat e sistemit elektronik të kallëzimeve përditësoheshin vazhdimisht kur bëheshin zëvendësime të prokurorit dhe si të tilla nuk mundësonin të dhënat fillestare të datës/emrit të prokurorit të caktuar për t'u vlerësuar në drejtim të shpërndarjes së çështjeve në një periudhë të caktuar. Për t'u shtuar në këtë drejtim edhe fakti i lëvizjeve të një numri të konsiderueshëm prokurorësh dhe që lëvizjet për shkak të procesit vetting kanë shkaktuar edhe zëvendësime të menjëhershme të prokurorëve me një numër ngarkese të konsiderueshme.

Referuar ngarkesës së prokurorëve në tërësi, për periudhën objekt inspektimi ashtu sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm, është konstatuar se prokurorët të cilët kanë ushtruar detyrën e drejtuesit të prokurorisë në pjesën më të madhe të periudhës objekt inspektimi dhe në pjesën më madhe të zyrave, kanë patur kryesisht ngarkesën më të ulët lidhur me numrin e çështjeve - kallëzime/referime penale të regjistruar në një zyrë prokurorie.

Më e dukshme kjo evidentohet në zyrat Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Lezhë ku ngarkesa e drejtuesit, referuar numrit të kallëzimeve/referimeve penale është shumë e ulët në raport me ngarkesën e prokurorëve të tjerë. Kështu në Tiranë ngarkesa e drejtuesit paraqitet 26 nga 17144 çështje me një numër prokurorësh efektivë rreth 50<sup>6</sup>; në Durrës 48 nga 5226 çështje me një numër prokurorësh efektivë rreth 22<sup>7</sup>; në Elbasan 46 nga 2211 çështje me një numër prokurorësh efektivë 13<sup>8</sup>, në Vlorë 21 nga 1956 çështje me një numër prokurorësh efektivë prej 13<sup>9</sup>, në Gjirokastrë ku ish drejtuesi për 6 muaj ka marrë 35 çështje dhe drejtuesi tjetër për pjesën tjetër të vitit, nuk ka marrë asnjë çështje, ndërkohë që numri total i kallëzimeve ka qenë 1095 dhe me një numër prokurorësh efektivë 5; në Fier, drejtuesi i ri i zyrës me datë fillimi 07.06.2023, ka marrë 1 nga 2241 çështje me një numër prokurorësh efektivë prej rreth 10<sup>10</sup> dhe Lezhë 37 nga 1775 çështje me një numër prokurorësh efektivë prej rreth 8<sup>11</sup>. Lidhur me këto zyra, në zyrat Tiranë, Fier, Vlorë,

<sup>6</sup> Referuar të dhënave në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm të vitit 2022

<sup>7</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>8</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>9</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>10</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>11</sup> E njëjtë si më sipër

Durrës, Elbasan, Lezhë referuar të dhënave përkatëse ngarkesa e drejtuesve përbëhej kryesisht nga çështje të cilat ata i kanë tërhequr vetë për t'u trajtuar, ndërsa në zyrat e tjera ngarkesa është krijuar kryesisht nga shorti elektronik. Lidhur me këtë mënyrë shpërndarje, nga drejtuesi i prokurorisë Vlorë është theksuar se drejtuesi i prokurorisë nuk është i planifikuar në sistemin elektronik, por se ata përfshihen gjatë gjithë muajit në grafikun e gatishmërisë duke komunikuar e dhënë orientime për çështje të një rëndësie të veçantë si dhe duke marrë pjesë aktive. Ndërsa nga drejtuesi i zyrës Lezhë, referohet marrja prej tij e çështjeve që kërkojnë veprime të menjëhershme, si një zgjidhje në kuadër të menaxhimit të tyre mbështetur në arsye të lidhur me sistemin CAMS si një sistem që nuk merr parasysh arsye objektive që mund të jenë shkak për përjashtimin e prokurorëve, si është kryesisht mungesa e prokurorit në ditën e hedhjes së shortit dhe pamundësia e kryerjes së veprimeve të menjëhershme, duke shtuar këtu edhe ngarkesën e prokurorëve si një arsye tjetër që mund të sjellë pamundësi për kryerjen e veprimeve të menjëhershme. Në zyrën Tiranë, Elbasan, Durrës, Sarandë, Vlorë, drejtuesi i zyrës rezultonte të ishte në të gjitha ditët e vitit i gatshëm, krahas prokurorëve të çështjes sipas seksioneve dhe drejtuesve të seksioneve. E njëjta mënyrë e të proceduari vihet re edhe në zyrën e prokurorisë Berat, ku ngarkesa e drejtuesit të prokurorit lidhet vetëm me çështje të tërhequra prej tij dhe nuk rezulton të jetë përfshirë në shortin elektronik. Konstatimi sa më sipër, është evidentuar edhe në inspektimin e mëparshëm dhe lidhur me këtë, referuar informacionit të njëres prej zyrave, si ajo Durrës, pavarësisht se nuk përfshihet në periudhën objekt zbatimi, është informuar se ka ndryshuar mënyra e të proceduarit duke u përfshirë në short elektronik edhe Drejtuesi i zyrës.

Përsa i përket zyrave Korçë, Shkodër, Kukës ngarkesa e drejtuesve të prokurorisë, rezulton një ngarkesë e konsiderueshme normale në raport me ngarkesën e prokurorëve të tjerë. Më konkretisht në Korçë 119 nga 2323 kallëzime me numër prokurorësh efektivë prej 8<sup>12</sup>, në Shkodër 173 nga 1846 kallëzime me numër prokurorësh efektivë prej 10<sup>13</sup> dhe në Kukës, drejtuesi i ri i prokurorisë me datë fillimi 01.08.2023, 208 nga 865 kallëzime me numër prokurorësh efektivë prej 5<sup>14</sup>. Në këto zyra, ngarkesa e drejtuesit është krijuar kryesisht me anë të shortit.

Në zyrën Dibër, ish drejtuesi i prokurorisë nuk ka qenë pjesë e shortit elektronik referuar urdhrit për përjashtim.

Gjithashtu në drejtim të shpërndarjes së çështjeve – kallëzime/referime penale, është evidentuar edhe fakti zv.drejtues/drejtues seksionesh në disa zyra, më evidente në Tiranë dhe Durrës, të cilët kanë qenë të tillë në pjesën më të madhe të periudhës objekt i këtij inspektimi dhe referuar gjithashtu qëndrueshmërisë së përbërjes së seksionit, rezultojnë të kenë një ngarkesë më të ulët në raport me ngarkesën e prokurorëve të tjerë. Ky raport është

---

<sup>12</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>13</sup> E njëjtë si më sipër

<sup>14</sup> E njëjtë si më sipër

i ndryshëm në rrethe të ndryshme, duke patur në konsideratë edhe volumin e ngarkesës së një seksioni në raport me volumin tërësor të ngarkesës së një prokurorie.

Në drejtim të garantimit të një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve në prokurori, nga drejtuesi i një zyre prokurorie dhe pikërisht, i zyrës Lezhë është shpjeguar se duke patur parasysh që sistemi CAMS bën shpërndarjen e shortit nëpërmjet një algoritmi të caktuar, për të patur një shpërndarje sa më korrekte të materialeve dhe për të mos mbingarkuar prokurorët, në institucionin e prokurorisë, shortet janë hedhur në momentin që numri i materialeve të regjistruara të jenë në përpjesëtim me numrin e prokurorëve, duke bërë kështu një baraspeshim të ngarkesës së menjëhershme. Ndërsa nga zyra e Tiranës, referuar raportit të punës për vitin 2023, duke u shprehur për funksionimin rregullisht të këtij sistemi shprehet për rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, përsa i përket mënyrës së ndarjes së çështjeve, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave.

Për garantimin e një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve, kryesisht nga të gjitha zyrat<sup>15</sup>, është proceduar me përjashtim të lidhur me ngarkesën, ndërsa evidentohet është konstatuar ndërhyrja e drejtuesit për përjashtim të prokurorëve nga shorti edhe për shkaqe të tjera si mjekësore; pjesëmarrje në trajnim; kandidimit apo përzgjedhjes si anëtar i KLP; angazhim në procesin e vlerësimit apo të rivlerësimit, për nxjerrjen e të dhënave për përgatitjen e raportit vjetor të punës në rastet e zëvendësimit apo drejtues seksioni, duke patur në konsideratë për këta të fundit edhe veprimtarinë e tyre administrative dhe procedurale përgjatë periudhës; për shkak të njoftimit për plotësimin e moshës së daljes në pension. Në disa zyra si Tiranë dhe Shkodër është proceduar me përjashtim nga shorti elektronik edhe për prokurorët të cilët janë shkarkuar/pezulluar në kuadër të procesit të rivlerësimit apo përfunduar statusi me vendim të KLP.

Përjashtimet e sipërpërmendura kanë qenë kryesisht me periudha të përcaktuara, si dhe kryesisht nga shorti elektronik. Edhe në ato zyra, si Sarandë e Dibër të cilët më ato raste kur drejtuesit janë shprehur për përjashtim nga shorti deri në një urdhër të dytë, është proceduar me përfshirje mbi bazë urdhri sërish. Veçanërisht në zyrën Korçë kryesisht përjashtimi nuk ka qenë me afat të përcaktuar dhe për rifutjen e prokurorëve në short është proceduar me urdhër verbal të drejtuesit, ndonëse sipas informacionit të përcjellë nga zyra Korçë lidhur me inspektimin e mëparshëm, për mënyrën e të proceduarit me përjashtim, parashtrohet se në çdo rast nxirret një urdhër ku jepet kohëzgjatja dhe shkaku i heqjes nga shorti.

Për përjashtimin nga shorti, nga të gjitha zyrat është proceduar me nxjerrjen nga drejtuesi të një akti me shkrim, të titulluar “urdhër”. Nga këto akte, nuk rezulton që në të gjitha zyrat të gjendet arsyetim i detajuar në drejtim të ngarkesës së prokurorit për të cilin urdhërohet

---

<sup>15</sup> Aty ku ka patur

përfshirë dhe në raport edhe me ngarkesën në tërësi. Përmendim këtu zyrat Korçë, Gjirokastër, Shkodër.

Për t'u evidentuar në ndryshim nga inspektimi i mëparshëm, referuar konstatimeve, edhe në zyrën Tiranë është proceduar me përjashtim të prokurorëve nga shorti mbi bazën e një akti me shkrim, të titulluar si edhe në zyrat e tjera "Urdhër", duke përcaktuar afatet përkatëse dhe shoqëruar me kërkesën përkatëse.

### **1.3. Mënyra e pasqyrit të të dhënave për shpërndarjen e çështjeve në prokurori**

Në të gjitha zyrat e prokurorive të inspektuara është konstatuar se shorti elektronik është kryer nëpërmjet përdorimit të sistemit Cams, duke regjistruar më parë këto çështje nga zyrat përkatëse. Ndërsa shorti manual është zhvilluar duke u mbajtur procesverbalet përkatëse të cilat ruhen si të tilla në zyrat përkatëse.

Shorti elektronik, në të gjitha zyrat është realizuar kryesisht brenda ditës së regjistrimit të materialeve, ndërsa janë evidentuar edhe vonesa më shumë se një ditë. Nga disa zyra<sup>16</sup>, referuar informacionit të tyre të përgjithshëm mbi kohën e shortimit është shpjeguar se përjashtimi nga rregulli i shortimit brenda ditës, është arsyetuar si e lidhur me rastet e materialeve të ardhura në orët e vona të orarit zyrtar të ditëve të premte, jashtë orarit zyrtar, në ditët përpara ditëve të pushimeve zyrtare, volumit të lartë të punës, apo për shkak të mosfunksionimit të sistemit elektronik. Lidhur me këtë të fundit, sistemit elektronik, kryesisht nga të gjitha zyrat nuk është paraqitur ndonjë problematikë në drejtim të mosfunksionimit. Zyra Vlorë ka informuar se sistemi CAMS ka patur raste të mosfunksionimit normal, por nuk e ka shoqëruar më tej me të dhëna të tjera më konkrete lidhur me periudhën kohore dhe komunikimet përkatëse për këtë qëllim. Volumi i punës, si shkak në ato zyra ku është paraqitur si shkak si ajo e Fierit, është evidentuar e lidhur me faktin se personat e përfshirë në procesin në fjalë kryejnë edhe detyra të tjera funksionale.

Nga zyra Lezhë është informuar për një mënyrë tjetër të të proceduarit nëpërmjet shortit elektronik, koha e të cilës është cilësuar si relative në raport me kohën e regjistrimit të materialit, duke vlerësuar numrin e materialeve e kohës së ardhjes së tyre nga njëra anë me numrit të prokurorëve nga ana tjetër. Kështu, drejtuesi i zyrës argumenton se *"për të patur një shpërndarje sa më korrekte të materialeve dhe për të mos mbingarkuar prokurorët, në institucionin e prokurorisë, shortet janë hedhur në momentin që numri i materialeve të regjistruara të jenë në përpjesëtim me numrin e prokurorëve, duke bërë kështu një baraspeshim të ngarkesës së menjëhershme"*.

Lidhur me vonesat në hedhjen e shortit, në zyrat Tiranë dhe Vlorë janë evidentuar edhe vonesa më shumë se 5 ditë, për të cilat vlerësohet të kryhen verifikime të mëtejshme. Nga zyra Tiranë, në informacionin e saj këto vonesa janë lidhur me numrin e lartë të materialeve të regjistruara dhe proceseve të punës që nga hyrja dhe deri në shortimin përkatës, nga njëra

<sup>16</sup> Referuar atyre zyra që kanë përfshirë në informacionin e përgjithshëm edhe atë mbi kohën e shortimit për rastet me vonesë më shumë se 1 ditë. Përmendim zyrat Berat, Fier, Shkodër, Sarandë dhe Durrës.

anë, largimit të një numri të madh të prokurorëve dhe dorëzimin prej tyre të një numri të madh dosjesh, të cilat passjellin angazhimin e të njëjtëve personave për të kryer ndryshimet përkatëse në regjistrë dhe regjistrimin e tyre. Nga zyra Vlorë, fillimisht është sqaruar se i gjithë procesi i mësipërm nga protokollimi deri në caktimin e prokurorit nga sistemi CAMS në përgjithësi bëhet brenda 2 ditëve, afat ky që mund të tejkalohet kur materialet vijnë në fund të orarit zyrtar në ditë premtë apo për shkak të ngarkesës, duke shtuar në vijim se CAMS ka patur raste të mosfunksionimit normal duke sjellë zgjatje në kohë të procesit të regjistrimit, por e pashoqëruar me të dhëna konkrete lidhur me këtë.

Përsa i përket shpërndarjes së materialeve sipas listës së gatishmërisë, referuar materialeve me të arrestuar në flagrancë/ndalimi me iniciativë është evidentuar ndjekja nga zyrat si ajo e praktikës së shpërndarjes duke marrë për bazë datën e referimit në prokurori dhe prokurorin e gatshëm në datën përkatëse<sup>17</sup>, ashtu edhe e praktikës së shpërndarjes duke marrë për bazë datën e arrestimit në flagrancë/ndalimi me iniciativë dhe prokurorin e gatshëm në datën përkatëse pavarësisht datës së hyrjes/protokollimit në prokurori<sup>18</sup>. Lidhur me këtë mënyrë të proceduari, nga zyrat është informuar se listat e gatishmërisë përgatiteshin në çdo fillim muaji nga drejtuesit e prokurorive të cilët kishin një shpërndarje të caktuar në ditë të prokurorëve në varësi të organikës së prokurorisë. Referuar të dhënave të listave të gatishmërisë dhe të dhënave dokumentare e elektronike lidhur me shpërndarjen e çështjeve në secilën prej zyrave të prokurorisë, u konstatua kryesisht përputhje të shpërndarjes së çështjeve sipas datave të gatishmërisë. Këto konstatime u bazuan në tërësinë e tyre në informacionin e administruar në kuadër të tematikës së inspektimit të cilat përfshinin formularë përkatës/të dhëna tabelare të sistemit të shortimit dhe caktimit të çështjeve, ku nuk evidentoheshin të dhëna mbi datat e arresteve në flagrancë/ndalimeve me iniciativë korresponduese me datën e gatishmërisë së prokurorit, në konsideratat e informacionit mbi mënyrën e të proceduarit nga zyrat. Këto konstatime u vunë re edhe në inspektimin e mëparshëm, dhe nga informacionet e marra pavarësisht se të dhënat nuk përfshihen në periudhën e zbatimit të rekomandimeve, vihet re se nga disa zyra, si Dibër, Shkodër, kanë filluar të merren masa lidhur me mbajtjen e regjistrit elektronik në drejtim të evidentimit të datës së arrestimit në flagrancë/ndalimit me iniciativë, ndërsa nga zyra Korçë është parashtruar se në regjistrin elektronik nuk ka një kolonë për datën e arrestit.

Gjithashtu, nga të dhënat e marra në kuadër të inspektimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, evidentohet se në disa zyra prokurorie si në Tiranë, Fier, Korçë, Durrës, Shkodër të dhënat e sistemit elektronik të kallëzimeve ndryshoheshin vazhdimisht kur bëheshin zëvendësime të prokurorit dhe si të tilla nuk mundësonin të dhënat fillestare të datës/emrit të prokurorit të caktuar. Ndërsa sipas informacionit të marrë nga zyrat, referuar rekomandimeve të inspektimit të mëparshëm, konstatohet se nga disa prej tyre si Durrës,

<sup>17</sup> E evidentuar qartë sipas informacionit kryesisht në zyrat e prokurorive Fier, Gjirokastrë, Korçë

<sup>18</sup> E evidentuar qartë sipas informacionit kryesisht në zyrat e prokurorive Vlorë, Sarandë, Lezhë, Shkodër, Durrës dhe Elbasan

Shkodër janë marrë masa për përditësimin e të dhënave fillestare duke pasqyruar në mënyrë kronologjike zëvendësimin e prokurorit.

Mënyra e të proceduarit në fjalë e lidhur me gatishmërinë e prokurorëve, sipas listave të miratuara në çdo fillim muaji, për të cilat kanë informuar zyrat përkatëse të prokurorive të inspektuara, është vënë re edhe në të dhënat dokumentare dhe elektronike të dërguar nga këto zyra për efekt të këtij inspektimi.

Procedura sa më sipër është dokumentuar me të dhënat në sistemin CAMS që përdorej për çështjet për të cilat procedohet elektronikisht. Nga disa zyra prokurorie si Tirana, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Kukës, Dibër, Korçë dhe Shkodër referuar informacionit dhe të dhënave të dërguar, konstatohet se në të dhënat tabelare pjesë e sistemit CAMS, përveç çështjeve të shortuar elektronikisht janë pasqyruar edhe çështjet për të cilat është proceduar manualisht, kryesisht, me veprime të menjëhershme apo me arrest. Këto çështje të fundit, regjistroheshin manualisht në këtë sistem i cili përdorej më pas edhe në rast zëvendësimi. Për këtë mënyrë të proceduari, në informacionet e përcjellë nga zyrat për efekt të konstatimeve dhe rekomandimeve të inspektimit të mëparshëm, nga disa prej tyre si Gjirokastrë, Sarandë, Shkodër, parashtrohet sërish e njëjta mënyrë për hedhjen në sistemin CAMS, edhe të çështjeve të tjera të caktuara prokurorëve jo me anë të shortit elektronik. Për këtë, drejtuesit e këtyre zyrave mbështeten në arsyen e përlogaritjes së ngarkesës së prokurorëve e cila passjellë edhe një shpërndarje më të drejtë të çështjeve.

Lidhur me shpërndarjen e çështjeve gjatë periudhës së lejeve, gusht, ashtu sikurse edhe nga inspektimi i mëparshëm nga shumë zyra nuk procedohet me short elektronik për çështje të cilat nuk kanë qenë me arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë apo me veprime të menjëhershme, të ngutshme janë proceduar me hedhjen në short elektronik pas datës 1 shtator, me rifillimin e punës. Kjo procedurë është konstatuar në zyrat Elbasan, Durrës, Berat, Korçë, Sarandë, Tiranë, Kukës, Vlorë, në të cilat jo në të gjitha është e bazuar në një akt të shkruar, edhe pse në informacion këtë mënyrë të proceduari e mbështetin kryesisht në arsyet e lejes vjetore dhe kohës kur ata marrin materialet në raport me afatin 15 ditor të parashikuar për shqyrtimin e trajtimin e një kallëzimi. Në vazhdim përmendim organizimin e zyrave të prokurorive Elbasan, Durrës:

Në zyrën Elbasan, kjo mënyrë e të proceduarit është normuar me urdhrin nr. 53, datë 25.07.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për organizimin dhe funksionimin e punës, delegimin e kompetencave si dhe dhënien e lejeve të zakonshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” gjatë pushimeve vjetore nga data 01 gusht 2023 deri më 04 shtator 2023”, ku është parashikuar se referimet dhe kallëzimet për të cilat është vlerësuar si e nevojshme kryerja e veprimeve të menjëhershme dhe të ngutshme hetimore, pas siglimit të drejtuesit të gatshëm, të regjistrohen në regjistrin e kallëzimeve, dhe t’i kalohen prokurorit të gatshëm kundrejt nënshkrimit, për kryerjen e veprimeve procedurale. Për çështjet e tjera, pas regjistrimit në librin e protokollit, siglimit nga drejtuesi i gatshëm dhe regjistrimin në zyrën e regjistrit, do t’i nënshtrihen shortit elektronik më datë 01.09.2023, ashtu siç është vepruar referuar

të dhënave të dërguar. Referuar urdhrit, kjo mënyrë e të proceduarit është ndjekur për shkak të mungesës së prokurorëve, për arsye të lejes vjetore dhe pamundësisë së tyre në këto kushte, për t'u shprehur brenda afateve procedurale në lidhje me disponimin e këtyre materialeve.

Në zyrën Durrës, kjo mënyrë e të proceduarit është normuar me udhëzimin nr. 47 datë 31.07.2023, ku është parashikuar shpërndarja e çështjeve me natyrë të ngutshme dhe pezullim i shortimit për çështjet e tjera, duke proceduar me shpërndarjen e tyre me short elektronik në datën 01.09.2023. Për këto çështje sipas urdhrit, në gusht në kohën e regjistrimit të tyre parashikohej ndarja sipas seksioneve përkatëse dhe regjistrimi i tyre nga zyra e regjistrimit.

Në ndryshim nga zyrat e tjera dhe nga inspektimi i mëparshëm, veçanërisht në zyrën Fier nuk rezulton të jetë pezulluar procedura e shortit elektronik për shpërndarjen e çështjeve që nuk kanë natyrë të ngutshme. Kjo mënyrë e të proceduarit është normuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.07.2023 *“Për organizimin e grafikut të gatishmërisë dhe marrjen e masave administrative e procedurale për funksionimin e prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*, sipas të cilit prokurorëve të gatshëm u kalojnë për shqyrtim, vlerësim dhe trajtim me prioritet dhe në afatet optimale në përputhje me ligjin çdo referim dhe /ose kallëzim për veprat penale që kërkojnë veprime të menjëhershme (arrestime në flagrancë, ndalime përgjime, veprime të tjera proaktive, sigurim prove etj); çdo kërkesë që lidhet me liritë personale të personale dhe që kërkohen veprime të menjëhershme (masat e sigurimit si shuarje, revokim etj, verifikimet e masave të sigurimit); çdo vendim gjyqësor me ekzekutim të menjëhershëm; çdo çështje tjetër që kërkon veprime të menjëhershme. Prokurorëve të gatshëm u kalojnë për shqyrtim materialet e referuara për hetim pas orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit. referimet/kallëzimet dhe materialet e tjera që paraqiten në prokurori gjatë muajit gusht, regjistrohen në kryesekretari në librin e protokollit dhe në vijim pas ndjekjes së procedurës administrative sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, u shpërndahen me short prokurorëve që janë në punë. Referimet/ kallëzimet dhe materialet e tjera që janë kompetencë e seksionit të posaçëm dhe që nuk kërkojnë veprime të ngutshme, të regjistrojnë në librin e protokollit dhe shpërndahen me prokurorëve sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Lidhur me shpërndarjen e materialeve të gushtit, ka zyra të tjera të cilat kanë proceduar me shpërndarjen e tyre manualisht midis një grupi të vogël prokurorësh apo ndarjen e tyre referuar listës së gatishmërisë duke marrë për bazë datën e referimit në prokurori dhe prokurorin e gatshëm në datën përkatëse. Kështu rastin e parë të përmendur e gjejmë në zyrën e Prokurorisë Shkodër ku për kallëzimet e regjistruar në muajin gusht është proceduar sipas urdhrit me nr. 44 datë 01.08.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë, për t'u hedhur në short manual në muajin shtator midis disa prokurorëve të përcaktuar të cilët rezultojnë me ngarkesë më të vogël, ndërsa rasti tjetër i përket zyrave Lezhë, Vlorë, Dibër dhe Gjirokastrë në të cilat për çështjet e referuar gjatë muajit gusht do të procedohet sipas listës së gatishmërisë, të cilëve do t'u shpërndahen si çështjet me arrestime ose ndalime,

por edhe ato kallëzime ose referime të tjera të zakonshme. Këtë mënyrë të proceduari drejtuesi i prokurorisë Gjirokastrë e ka normuar me urdhrit nr. 03 datë 26.07.2023, ndërsa drejtuesi i zyrës Dibrë në listën e gatishmërisë së muajit gusht. Për këtë periudhë, është parashikuar që procedurat e shortit të zakonshëm do të pezullohen.

Për mënyrën e të proceduarit për periudhën e gatishmërisë, sipas informacioneve të marra në kuadër të konstatimeve e rekomandimeve të inspektimit të mëparshëm, nga një pjesë e zyrave është informuar mbi këtë mënyrë. Kështu zyra Gjirokastrë, vazhdon me të njëjtën mënyrë të proceduari duke i kaluar çështjet prokurorit të gatshëm dhe sërish mbi bazën e një urdhri me shkrim; zyrat Korçë, Kukës vazhdojnë me të njëjtën mënyrë të proceduari duke mos u proceduar në gusht me shpërndarje të çështjeve që nuk kanë ngutshmëri, por në fillim të shtatorit, ndërsa nuk shprehet nëse kjo mënyrë është normuar me urdhër; Veçanërisht nga zyra Korçë për këtë mënyrë të proceduari, arsyetohet lidhur me mungesën e infrastrukturës për hedhjen në short dhe dorëzimin e çështjeve tek prokurorët (mungon personi që hedh shortin, mungon prokurori që merr çështjen me firmë, etj.). zyra Vlorë ka informuar se në ndryshim nga periudha e mëparshme e të proceduarit kur për materialet të cilat nuk ishin me veprime të menjëhershme, procedohej në muajin shtator, në vazhdim do të procedohet me ndarjen sipas listës së gatishmërisë. Lidhur me shkakun e të proceduarit për periudhën e mëparshme për çështjen e regjistruar në gusht, drejtuesi i zyrës arsyeton lidhur me afatet kohore të kallëzimeve për të cilat mund të vendoset mosfillimi i çështjes penale.

## **2. Prokuroria e Apelit<sup>19</sup>**

### **2.1. Mënyra e caktimit të çështjeve**

Periudha e inspektimit ka përfshirë një periudhë kohe prej 1 muaji, të veprimtarisë së ish zyrave të Prokurorisë të Apelit, të cilat për shkak riorganizimi në kuadër të hartës gjyqësore , me datën 01.02.2023 kanë ndërprerë veprimtarinë dhe kanë pushuar së ekzistuari, duke u vazhduar funksionimi i shkallës së apelit të prokurorisë, nën emërtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në Tiranë.

Referuar kësaj periudhe 1 mujore të inspektimit në këto ish zyra të prokurorisë të Apelit, evidentohet ashtu sikurse në periudhën e vitit 2022, sipas inspektimit të mëparshëm me të njëjtën tematikë, se në këto zyra kryesisht është ndjekur e njëjta procedurë me anë të caktimit të prokurorit me short manual, ndërsa nuk është proceduar në këtë mënyrë në zyrën e Apelit Gjirokastrë. Në këtë të fundit, edhe në këtë periudhë inspektimi, çështjet në gjykim janë përfaqësuar nga prokurori i vetëm efektiv në prokurori.

Në periudhën 1 mujore në fjalë, nga ish zyrat e prokurorisë Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë e Gjirokastrë është evidentuar caktim i prokurorit për përfaqësim në një numër të vogël çështjesh, për shkak të edhe të masave të marra nga gjykata në kuadër të riorganizimit,

<sup>19</sup> Do t'i referohemi këtij emërtimi duke patur në konsideratë riorganizimin në kuadër të hartës gjyqësore dhe se inspektimi ka përfshirë pjesën më të madhe të kësaj zyre.

ndërsa ky numër është më i madh në zyrën Tiranë ku edhe do të vijonte funksionimi i Prokurorisë së Apelit më datë 02.02.2023. Njoftimet përkatëse nga gjykata në këtë periudhë, me qëllim caktimi të prokurorit për përfaqësimin e organit të akuzës në gjykatë, sipas informacionit të zyrave të Shkodrës, Korçës dhe Vlorë, ka qenë kryesisht për çështje me objekt masash sigurimi apo për çështje të tjera të karakterit të ngutshëm kryesisht të lidhur me mbarimin e afateve të paraburgimit. Ndërsa konstatohet që në zyrat Durrës, është proceduar normalisht për të gjitha çështjet duke u zhvilluar shorti manual për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Për periudhën 11 mujore, në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është evidentuar ndjekja e praktikës të ish Prokurorisë së Apelit Tiranë, të konstatuar në inspektimin e mëparshëm, sipas të cilit procedohej me short manual për çështjet e themelit dhe të çështjeve të tjera të karakterit administrative -penal, ndërsa për çështjet e masave të sigurimit, përfshirë këtu edhe to për lejim kontrolli, revokim mase sigurimi, shtrim i përkohshëm në spital psikiatrik, zgjatje afati, sekuestro, etj, të karakterit të ngutshëm, caktimi bëhej sipas listës së gatishmërisë.

Procedura e shpërndarjes së çështjeve me short manual është realizuar bazuar në njoftimet përkatëse të gjykatës për datën e gjykimit të një çështje e cila protokollohej në zyrën e prokurorisë, pasuar me administrimin e dosjes nga ana e kryesekretarisë, ndarjen e dosjeve në grupe në drejtim të numrit të prokurorëve dhe kategorisë së veprës penale, dhe për të vijuar më tej me shortimin përkatës, pas njoftimit paraprak të prokurorëve për kohën e shortimit, me anë të emailit zyrtar. Pasi kryesekretaria sigurohet për realizimin e njoftimit, në orën dhe datën e caktuar prokurorët paraqiten vetë personalisht apo delegojnë sekretaret e përzgjedhur prej tyre, për zhvillimin e procedurës së shortit.

Në lidhje me afatin kohor të hedhjes së shortit, referuar momentit kohor në të cilin bëhet hyrja fizike e dosjes nga gjykata, nuk ka një afat kohor fiks për këtë rast, dhe kjo tolerancë vjen për shkak se dosjet e përcaktuara nga gjyqtarët për t'u gjykuar, sillen prej tyre, në periudha të ndryshme kohore.

Për procedurën e shortit, mbahet procesverbali përkatës nga kryesekretaria dhe drejtuesi, dhe në përfundim bëhet plotësimi në regjistër në kolonën përkatëse të prokurorit të çështjes së shortuar dhe dosjet fizikisht kalojnë në dispozicion të prokurorit të shortuar për t'u studiuar.

Për çështjet me objekt masë sigurimi, për shpërndarjen e tyre procedohej sipas listës së gatishmërisë të përgatitur paraprakisht nga drejtuesi i Prokurorisë, ku përcaktohet saktësisht periudha kohore që secili prokuror mbulon si i gatshëm, bazë mbi të cilën i kalojnë dhe dosjet e masave të sigurimit që regjistrohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për këtë periudhë. Kjo periudhë kohore është e barabartë për çdo prokuror. Pasi nga ana e sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Apelit, bëhet njoftimi për regjistrimin e dosjeve së masave të sigurimit, Kryesekretaria e Prokurorisë së Apelit siguron marrjen fizike të dosjeve dhe i bën hyrje/protokollim në regjistrin çështje masa

sigurimi, duke regjistruar në këtë regjistër emrin e të hetuarit, veprat penale, numrin e regjistrimit themeltar të Gjykatës së Apelit, kërkesën e prokurorit të shkallës së parë dhe vendimin e gjykatës, me numër vendimi, datë dhe dispozitiv si dhe palën ankuese. Më pas dosjet i ndahen sekretareve për të bërë fotokopje të akteve që i vihen në dispozicion prokurorëve për t'ua përfaqësuar çështjen në gjykim në gjykatë.

Gjithashtu për t'u evidentuar që në këtë zyrë prokurorie, Apeli i Juridiksionit të Përgjithshëm është proceduar me përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për caktimin e prokurorit si me anë të shortit manual dhe sipas listës së gatishmërisë, vetëm për çështjet e caktuara një prokurore. Kjo mënyrë e të proceduarit, është caktuar me marrëveshje të të gjithë prokurorëve të zyrës, dhe e formatizuar edhe me vendimin përkatës të Drejtuesit të Prokurorisë mbështetur në arsye shëndetësore të prokurorit. Prokurorit në fjalë, i janë lënë për përfaqësim çështje penale që kanë objekt kundërshtim vendim mosfillimi dhe pushimi të procedimit, çështje që gjykohen nga Gjykata në dhomë këshillimi, pa prezencën e palëve. Ashtu sikurse është informuar nga vetë zyra në kuadër të këtij inspektimi, *'kjo zgjedhje është bërë thjesht duke u nisur nga parime humane ndaj koleges që aktualisht është në gjendje shumë të vështirë shëndetësore.'*

Përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i sipërpërmendur për shpërndarjen e çështjeve në prokurori, referuar informacionit të sjellë nga zyrat është bërë kryesisht në rastet e gjykimit të çështjeve që lidhen me çështjet e gjykuara për të cilat ishte caktuar më parë prokurori, të tilla që lidhen me masa sigurimi, të çështjeve që vinin nga Gjykata e Lartë dhe që ishin përfaqësuar nga i njëjti prokuror në Gjykatën e Apelit apo të çështjeve të tjera lidhur me kërkesa gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit. Për këto raste çështja i është kaluar të njëjtit prokuror të caktuar më parë.

## **2.2. Raporti i shpërndarjes së çështjeve midis prokurorëve**

Referuar informacionit të përcjellë nga zyra e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për periudhën 11 muaj, periudhë kjo që të lejon të vlerësosh në mënyrë më të plotë këtë shpërndarje të të gjithë çështjeve në raport me numrin e prokurorëve, konstatohet se procedura e shortit në funksion të garantimit të një ndarje të barabartë të çështjeve midis prokurorëve paraprihej nga grupimi i çështjeve bazuar në numrin e prokurorëve dhe kategorinë e veprave penale. Nga zyra në fjalë informohej se nisur nga fakti se dosjet e përcaktuar nga gjyqtarët për t'u gjykuar sillen në periudha të ndryshme kohore, me dakortësinë dhe të stafit të prokurorëve, pritet që të grumbullohet një numër dosjesh i mundshëm për t'u ndarë dhe pastaj hidhet shorti. Më tej, në këtë informacion, është vijuar se kjo është një situatë që vazhdon të ndiqet nga gjyqtarët, me gjithë përpjekjet e zyrës së prokurorisë për të patur në fund të muajit listën e plotë të gjykimeve që do të zhvillohen në muajin pasardhës, e cila do të normonte shortin vetëm në një seancë në muaj duke patur një ndarje të drejtë. Kjo situatë, sipas zyrës së prokurorisë, vjen për shkak të mbingarkesës që po has Gjykata e Apelit, e cila ka passjell jo në pak raste edhe vënien në dispozicion të dosjeve gjyqësore një ditë përpara seancës për përfaqësimin në gjykim apo në raste të rralla

edhe brenda kësaj dite, për shkak të masave të sigurimit dhe afateve që normojnë shuarjen e tyre në rast të mosrespektimit të gjykimit në kohë.

Referuar informacionit sa më sipër dhe të dokumentacionit të administruar nga zyra e prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çështjet janë shpërndarë ndërmjet 13 prokurorëve ku përfshihet edhe drejtuesi i prokurorisë. Për njërin prej prokurorëve, nga ana e Drejtuesit të prokurorisë, ashtu siç është përmendur më sipër është proceduar me vendim për përjashtimin nga lista e gatishmërisë dhe nga shortimi i çështjeve penale që kërkojnë prezencën në sallë të gjykimit të prokurorit. Kjo mënyrë e të proceduarit, rezulton të jetë marrë bazuar në shkaqe shëndetësore të prokurorit dhe pas diskutimit e dakordësisë me të gjithë trupën e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit.

Gjithashtu përveç këtij rasti, janë konstatuar edhe katër raste të tjera të përjashtimit të prokurorit nga lista e gatishmërisë, ndonëse jo të gjitha të materializuara dhe të cilat lidhen kryesisht me përfundimin e mandatit të prokurorit me vendim të KPK dhe KLP, si dhe në dy raste të tjera për shkak të gjendjes shëndetësore. Për periudhat në fjalë të gatishmërisë, nga ana e drejtuesit është proceduar me caktimin e prokurorëve të tjerë të zyrës, duke përfshirë edhe veten e tij.

Shpërndarja e çështjeve midis prokurorëve në këtë zyrë, duke marrë në konsideratë prokurorët efektivë përgjatë gjithë periudhës për të cilët nuk është proceduar me përjashtimet përkatëse sa më sipër, rezulton në numër në diferenca midis tyre në çështjet e themelit dhe masat e sigurimit, që në tërësinë e tyre shkojnë në vlerën e mesatares prej 43 çështje, për një ngarkesë mesatare për prokuror referuar ngarkesës së tyre me 314. Nga ngarkesa e secilit prej prokurorëve, rezulton se drejtuesi i prokurorisë renditet i dyti, si në total të të dyja kategorive të çështjeve ashtu edhe në veçanti.

### **3.3. Mënyra e pasqyrimin të të dhënave për shpërndarjen e çështjeve në prokurori**

Menjëherë pas shortimit, mbahet procesverbal nga kryesekretaria dhe Drejtuesi për mënyrën e përfundimit të shortit. Pas përfundimit të shortit manual, është konstatuar se pas caktimit të emrit të prokurorit, nga ana e sekretarisë bëheshin shënimet përkatëse në regjistër deri në përfundimin e tyre. Lidhur me problematika në procesin e shpërndarjes së çështjeve, është informuar se nuk janë hasur të tilla.

Për pasqyrimin e shpërndarjes së çështjeve është konstatuar mbajtja e regjistrave përkatës të ndarë në çështje themeli dhe masa sigurimi. Në formatin e regjistrave të mbajtur nga kjo zyrë prokurorie është evidentuar, ashtu sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm të vitit 2022, se nuk rezultonte i pasqyruar data e hyrjes në prokurori të njoftimit nga gjykata për zhvillimin e një gjykimi, e konsideruar e rëndësishme në drejtim të identifikimit të qartë të shpërndarjes së çështjes si në drejtim të procedurës së shortit ashtu edhe sipas gatishmërisë.

### **Rekomandimet nga inspektimi pararendës i së njëjtës natyrë dhe zbatimi i tyre**

Referuar gjetjeve dhe rekomandimeve të inspektimit të mëparshëm, nga informacioni i marrë nga Prokuroria e Apelit, evidentohet se nga ana e kësaj zyre është vlerësuar dhe patur në konsideratë të dhënat e konstatuara duke ia bërë me dije të gjithë trupës së prokurorëve.

### **3. Prokuroria e Përgjithshme**

#### **2.1. Mënyra e caktimit të çështjeve**

Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilat lidhen me përfaqësimin e prokurorisë në Gjykatën e Lartë është proceduar me caktimin e prokurorit me short manual. Shpërndarja e çështjeve me anë të shortit manual bëhej ndërmjet prokurorëve të Drejtorisë Gjyqësore.

Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilat lidhen me përfaqësimin e prokurorisë në Gjykatën Kushtetuese, nuk është proceduar me short, por përfaqësimi i tyre është bërë nga prokurorët që ushtronin funksionet në Drejtorinë Gjyqësore, mbi bazën e autorizimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Për këto çështje është proceduar me ndarje nga Drejtori i Drejtorisë Gjyqësore sipas ngarkesës së punës së prokurorëve ose bazuar në faktin nëse e njëjta çështje është përfaqësuar nga i njëjti prokuror edhe në Gjykatën e Lartë. Referuar periudhës objekt inspektimi, njoftimeve të regjistruar për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese dhe numrit të prokurorëve që ushtronin detyrën në Drejtorinë Gjyqësore në periudhën përkatëse, evidentohen dy prokurorë që të jenë ngarkuar me ndjekjen e këtyre çështjeve.

Referuar informacionit të marrë lidhur me procedurën e ndjekur, njoftimi nga Gjykata e Lartë dhe Kushtetuese për seancën gjyqësore fillimisht regjistrohet në regjistrin e korrespondencës dhe i përcillet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili nëpërmjet shënimit përkatës ia delegon këtë njoftim Drejtorit të Drejtorisë Gjyqësore. Ky i fundit në prezencë të prokurorëve të drejtorisë dhe sekretares, organizon shortin për shpërndarjen e çështjeve që janë për përfaqësim në Gjykatën e Lartë, ndërsa cakton prokurorin që do të autorizohet për përfaqësimin e çështjeve në Gjykatë Kushtetuese.

#### **2.2. Raporti i shpërndarjes së çështjeve midis prokurorëve**

Në Drejtorinë Gjyqësore të Prokurorisë së Përgjithshme, si drejtoria e ngarkuar për përfaqësimin e çështjeve në gjykim në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese, ka pasur një prokuror që ka ushtruar detyrën e prokurorit në mënyrë të vazhdueshme dhe në vazhdim i janë bashkuar edhe dy prokurorë të tjerë të caktuar me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, ndërsa rezulton se për shkak të nevojave, janë caktuar edhe dy prokurorë të tjerë nga Drejtoria e Koordinimit Institucional të cilët, krahas detyrave në drejtoritë e tyre, kanë ushtruar dhe detyrën e përfaqësimit të çështjeve.

Caktimi i prokurorëve që ushtrojnë funksionet në drejtoritë e tjera, për përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, është bërë nëpërmjet një urdhri të Prokurorit të Përgjithshëm

“Për delegimin e kompetencave”. Nëpërmjet këtij urdhri janë ngarkuar dy prokurorë të një drejtorie tjetër që krahas detyrave në drejtoritë e tyre, të ushtronin edhe detyrën e përfaqësimit të çështjeve në Drejtorinë Gjyqësore për një periudhë kohe 6 mujore.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke pasur në konsideratë njoftimet për përfaqësim në Gjykatën e Lartë rezulton një shpërndarje midis prokurorëve të Drejtorisë Gjyqësore me një diferencë në numra rreth 8 nga tërësia e çështjeve në mesatare prej rreth 51 çështje.

### **3.3. Mënyra e pasqyrimit të të dhënave për shpërndarjen e çështjeve në prokurori**

Procedura e shortimit manual është organizuar nga Drejtori i Drejtorisë Gjyqësore të Prokurorisë së Përgjithshme, në prezencë të prokurorëve përkatës dhe sekretares, duke u mbajtur procesverbalet përkatëse. Prokurorët e përfshirë janë kryesisht 3 prokurorë të Drejtorisë Gjyqësore të cilët ushtrojnë detyrën e përfaqësimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, por mbi bazën e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm në rastet e mbingarkesës së prokurorëve të Drejtorisë Gjyqësore janë caktuar edhe 2 prokurorë të Drejtorisë së Koordinimit Institucional.

### **Rekomandimet nga inspektimi pararendës i së njëjtës natyrë dhe zbatimi i tyre**

Nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është sjellë ndonjë informacion.

#### **✦ Procedura e ndjekur për caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në zyrën e Prokurorisë së Posaçme**

### **1. Mënyra e caktimit të çështjeve**

Për shpërndarjen e çështjeve është proceduar si rregull me caktimin e prokurorit me short manual dhe referuar nenit 15 pika 2, shkronja “b” të ligjit me nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Procedura në fjalë paraprihej kryesisht nga regjistrimi i çdo çështje nga ana e kryesekretarisë së prokurorisë dhe grupimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë sipas seksioneve përkatëse që funksionojnë në zyrën e prokurorisë, për t’u kaluar më pas në procedurën e caktimit të prokurorit përkatës.

Procedura sa më sipër ka përfshirë kryesisht të gjitha llojet e çështjeve për të cilat është proceduar me caktim prokurori, si – materialet hetimore; kallëzim; materialet hetimore të ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore; kërkesat për përfaqësim në gjykim në gjykatë referuar kompetencave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe në Gjykatën e Lartë, kërkesa në fazën e ekzekutimit, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, nga viktimat akuzuese bazuar në nenin 59 të K.Pr.Penal, etj, si dhe materialet e referimit pasuror.

Për kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë është informuar se këto materiale përcillen tek Drejtuesi i Prokurorisë, nga ana e Kryesekretarisë së Prokurorisë. Pas siglimit të Drejtuesit të Prokurorisë për kërkesat në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, këto materiale i caktohen Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta i cili përbëhet Drejtuesi i Sektorit, një nga prokurorët e posaçëm, i cili emërohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për një periudhë trevjeçare. Për sektorin në fjalë, është informuar se është ngritur në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 95/2016 *“Për Organizmin dhe Funksionimin e Institucioneve Për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*. Ndërsa në lidhje me kërkesat për ndihmë juridike të cilat depozitohen në Prokurori në kuadër të procedimeve penale apo në kuadër të skuadrave të përbashkëta hetimore, këto kërkesa u caktohen prokurorëve që ushtrojnë ndjekjen penale në lidhje me këto procedime penale, për të vijuar në vazhdimësi me hetimin.

Për çështjet për të cilat nuk procedohej me short manual, caktimi i tyre ka qenë i mbështetur kryesisht në shpërndarjen mbi bazën e gatishmërisë dhe mbi bazën e lidhjes me një çështje të caktuar më parë dhe që është ende në hetim. Lidhur me gatishmërinë, çështja i kalohej prokurorit të gatshëm sipas listës së gatishmërisë, e cila pasqyrohej në fillim të çdo muaji. Ndërsa lidhur me çështjet e lidhura, është proceduar me kalimin e çështjes së fundit prokurorit që ndjek çështjen e regjistruar më parë. Edhe për këto materiale, është ndjekur e njëjta procedurë si në shpërndarjen e çështjeve të tjera si më sipër, duke u regjistruar pas depozitimit në sekretari dhe siglimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë.

Me përfundimin e procedurës së caktimit të çështjeve materialet sipas informacionit shpërndaheshin brenda 1 ditë tek prokurorët përkatës.

## **1.2. Shpërndarja e çështjeve midis prokurorëve**

Referuar informacionit të sjellë nga Prokuroria e Posaçme, numri i prokurorëve që kanë ushtruar detyrën në këtë zyrë gjatë vitit 2023, ka qenë 18 ndër të cilët edhe drejtuesi i zyrës. Në shpërndarjen e çështjeve janë përfshirë të gjithë prokurorët e organizuar në 3 seksione, të cilët gjithashtu janë përfshirë si të tillë edhe në grafikun e gatishmërisë për çdo muaj. Në listën e gatishmërisë rezultojnë të jenë të përfshirë edhe drejtuesi i prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve, në një kolonë të veçantë duke ndarë në mënyrë të barabartë ditët e muajit që mbulonin për efekt gatishmërie.

Prokurorëve në detyrë gjatë vitit 2023, iu janë caktuar çështje të të gjitha llojeve të përfshirë në tërësinë e tyre dhe të shpërndarë sipas procedurës së ndjekur në këtë zyrë, e cila drejtohej dhe mbikëqyrej nga drejtuesi i zyrës. Për caktimin e çështjeve, është mbajtur në konsideratë ndarja e prokurorëve sipas seksioneve, e cila realizohej nga drejtuesi i zyrës përpara shpërndarjes së çështjes. Në procedurën e shpërndarjes së çështjeve drejtuesi i zyrës në rast mungese, është zëvendësuar nga drejtuesi i caktuar me autorizim.

Shpërndarja e çështjeve nëpërmjet procedurës së shortimit është realizuar ndërmjet dy seksioneve të cilat kanë qenë të përbërë përkatësisht nga 7 dhe 9 prokurorë, ndërsa seksioni i tretë është ai i emërtuar Seksioni i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetime të Përbashkëta, i sipërcituar si i ngritur sipas nenit 22 të ligjit me nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe që ka në përbërje të tij një prokuror.

### **1.3.Mënyra e pasqyrimit të të dhënave për shpërndarjen e çështjeve në prokurori**

Procedura e shpërndarjes së çështjeve në prokurori është evidentuar me anë të mbajtjes së procesverbaleve në rastin e shortit manual dhe formularit për trajtimin e materialit/procedimit/kërkesës në rastin e caktimit të prokurorit nga drejtuesi bazuar në nenin 15, shkronja “b” e ligjit me nr. 95/2016.

Procesverbali për shortin mbahej nga sekretarja pranë Drejtuesit të Prokurorisë, dhe përfshinte rubrikat e nënshkrimit të drejtuesit të zyrës dhe prokurorëve të seksionit ndërmjet të cilëve realizohej shpërndarja e çështjeve. Ky procesverbal shoqërohej me formularin e trajtimit të nënshkruar nga drejtuesi i zyrës që përfshinte edhe rubrikën lidhur me siglimin/shënime të drejtuesit dhe marrjen në dorëzim nga prokurori i caktuar për trajtimin e materialit.

Për procedurën e caktimit të prokurorit nga drejtuesi bazuar në nenin 15 shkronja “b” e ligjit me nr. 95/2016 procedohej me aktin ‘formularin për trajtimin e materialit/procedimit/kërkesës’ që mbahej nga drejtuesi i zyrës, në të njëjtin format si më sipër duke përfshirë edhe rubrikën lidhur me siglimin/shënime të drejtuesit dhe marrjen në dorëzim nga prokurori i caktuar për trajtimin e materialit.

### **Rekomandimet nga inspektimi pararendës i së njëjtës natyrë dhe zbatimi i tyre**

Referuar gjetjeve të inspektimit të mëparshëm, nga zyra në fjalë informohemi se problemi i sistemit të Menaxhimit të Çështjeve ka qenë përgjatë vitit 2024 objektiv parësor, ku pas një pune voluminoze nga ana e strukturës së Prokurorisë së Posaçme në bashkëpunim dhe me partnerin e rëndësishëm ICITAP është bërë e mundur në muajin dhjetor 2024 vënja në funksionim (pilotimi dhe testimi) i këtij sistemi, pothuajse në tërësinë e moduleve të tij si (portal, protokoll, zyra e drejtuesit, prokurori, regjistri dhe hetuesi). Në vitin 2025, vijon informacioni po punohet për të garantuar brenda vitit *përfundimin dhe vënien në funksionim edhe të moduleve të tjera si raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letërporosive, të cilat do të mundësonin përmirësimin tejet të rëndësishëm të punës së përditshme të të gjitha strukturave të institucionit*. Gjithashtu nga kjo zyrë theksohet se: *“Që në fillim të veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme një ndër objektivat kryesorë ka qenë ngritja dhe implementimi i një sistemi menaxhimi që mundëson krijimin e një regjistri elektronik/bazë të dhënash, që passjell ndjekje dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis prokurorëve dhe*

*hetuesve, duke bërë analizimin e këtij informacioni në funksion të nxjerrjes së raporteve dhe statistikave të sakta dhe në kohë reale, lehtësimi të punës, transparencës si dhe rritjes së besimit të publikut në drejtësi. Gjithashtu ndërtimi i këtij sistemi dhe funksionimi i tij do të bëjë të mundur përveç të tjerave dhe administrimin dhe menaxhimin shumë më të mirë të të gjitha burimeve logjistike dhe njerëzore.”*

### **III. Analiza e të dhënave të konstatuara**

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat përkatëse të prokurorive është fokusuar në respektimin e ligjit organik dhe akteve nënligjore përkatëse në fuqi që rregullojnë caktimin e çështjeve në prokurori në funksion të transparencës dhe raportit të drejtë të ngarkesës mes prokurorëve. Gjithashtu në këtë analizë, është marrë në konsideratë edhe infrastruktura funksionale që kërkon procedura e shpërndarjes së çështjeve në prokurori.

Procedura për caktimin e çështjeve në prokurori është rregulluar nga i njëjti kuadër ligjor, i pandryshuar sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm, për Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm në ligjin bazë organik të Prokurorisë me nr.97/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.03.datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” i ndryshuar dhe për Prokurorinë e posaçme referuar parashikimeve të ligjit të sipërpërmendur në ligjin organik të Prokurorisë së Posaçme me nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i ndryshuar.

**Për zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm**, referuar ligjit të sipërpërmendur, neni 53 i tij, është parashikuar se shpërndarja e çështjeve në prokurori bëhet sipas procedurave të përcaktuara në rregullat e detajuara nga Prokurori i Përgjithshëm sipas të cilit çështja i caktohet paraprakisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar kryhet me short, në mënyrë elektronike. Bazuar në këtë parashikim ligjor, udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm ka përcaktuar në vijim edhe mënyrën e të proceduarit, përjashtimet përkatëse nga rregullimi i përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë si personin përkatës që drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjes. Rregullimi i detajuar i parashikuar në udhëzimin në fjalë, sipas parashikimit të vetë udhëzimit në fjalë, është kryesisht për prokuroritë e shkallëve të para, ndërsa për zyrat e apeleve dhe Prokurorinë e Përgjithshme do të zbatohen për aq sa është e mundur.

Referuar udhëzimit në fjalë, ashtu siç është parashikuar në ligj, shpërndarja e çështjeve që paraqiten në prokurori, si rregull realizohet me anë të shortit elektronik. Përjashtim nga rregulli në fjalë, bëhet për një kategori çështjesh që lidhet me a) materialet e referuara për hetim pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare; b) referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme; c) çështjet e pushuara, pezulluara apo të mosfilluara më parë, për të cilat më vonë është vendosur rifillimi i ndjekjes penale.

Lidhur me rastet përjashtimore nga rregullimi i përgjithshëm, më konkretisht për dy kategoritë e çështjeve të para është parashikuar se ato do t'i kalojnë prokurorit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga drejtuesi i prokurorisë, por kur janë në numër të madh mund t'i nënshtrohen procedurave të shortit, sipas rregullave të parashikuar në të njëjtin udhëzim. Ndërsa për kategorinë e tretë të çështjeve është parashikuar se ato do t'i kalojnë prokurorit që e ka ndjekur fillimisht hetimin dhe në rast se ky i fundit ndodhet me leje, është transferuar ose heq dorë, çështja i caktohet një prokurori tjetër në përputhje me rregullin e përgjithshëm, duke iu nënshtuar shortit elektronik.

Caktimi i çështjeve në prokurori me anë të mënyrës së të proceduarit sipas rregullave të detajuar në udhëzim, ashtu siç është parashikuar edhe në ligj duke proceduar fillimisht me grupimin e çështjeve sipas komisarivateve nga të cilat janë referuar, seksioneve apo grupveprave penale dhe ndarjen manuale nëpër grupe prokurorësh me nga jo më pas se tre prokurorë duke respektuar specializimin/ndarjen në seksione, për të kaluar në ndarjen me short elektronik të çështjeve brenda grupit për të siguruar një ndarje në raport të barabartë.

I gjithë procesi sa më sipër, sipas udhëzimit në fjalë, drejtohet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Prokurorisë i cili duhet të sigurojë paanshmëri, pavarësi dhe efikasitet në punën e prokurorisë. Në zhvillimin e këtij procesi, është parashikuar që drejtuesi ndihmohet nga zëvendësdrejtuesi, drejtuesi i seksioneve dhe prokurori përgjegjës për mbajtjen e regjistrit, të cilët duhet të bëjnë dokumentimin përkatës si dhe të respektojnë afatet kohore të vendosura. Kështu për referimet dhe kallëzimet që nuk kërkojnë veprime të menjëhershme është parashikuar që për to të procedohet në fund të ditës së paraqitjes në prokurori ose kur kjo ditë është ditë pushimi zyrtar, në ditën e mëpasshme të punës. Ndërsa për zyrat e prokurorive të Apeleve dhe të Përgjithshme është parashikuar shortimi i tyre brenda 2 ditëve nga marrja njoftim për datën e shqyrtimit të çështjes në gjykatën respektive. Pas përfundimit të procedurës së shpërndarjes së çështjeve, Zyra e regjistratit/sekretaria kryen shënimet përkatëse në regjistrat penalë dhe ia kalon praktikën prokurorit të caktuar me çështjen brenda 24 orëve.

Në funksion të ndarjes së barabartë të çështjeve, në udhëzim është parashikuar që drejtuesi mund të parashikojë një raport tjetër të ndarjes ndërmjet prokurorëve. Nga procedura e caktimit të çështjeve, e parashikuar në udhëzimin në fjalë nuk përjashtohet edhe drejtuesi i prokurorisë, për të cilin është vlerësuar ngarkesa që ai mund të marrë dhe që do të jetë në varësi të madhësisë së prokurorisë dhe ngarkesës së saj. Gjithashtu në kuadër të garantimit të efikasitetit të punës dhe një shpërndarje të drejtë të ngarkesës mes prokurorëve, është parashikuar edhe mundësia e drejtuesit të prokurorisë për të vlerësuar përjashtimin me urdhër të arsyetuar një ose disa prokurorë nga pjesëmarrja në short. Përjashtimi parashikohet për rastet kur prokurori ka papajtueshmëri për ndjekjen e çështjeve, kur ka ngarkesë apo kompleksitet të çështjeve në trajtim dhe për arsye të justifikuara; në rastet e parashikuara në nenin 26 të ligjit me nr. 96/2016; si dhe në rastet e magjistratit udhëheqës për kandidatin magjistrat për të cilin është parashikuar përjashtimi nga hedhja e 10-të e shortit për ndarjen e çështjeve.

Në drejtim të funksionalitetit të të proceduarit me short elektronik në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, sipas udhëzimit të lartpërmendur është parashikuar se do të kryhet në ato zyra ku është realizuar teknikisht dhe ngritur infrastruktura e nevojshme për hedhjen e shortit elektronik, dhe në rast se nuk është e mundur procedura e hedhjes së shortit do të bëhet manualisht. Për marrjen e masave për realizimin teknik dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për hedhjen e shortin elektronik, është ngarkuar në udhëzim Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Referuar parashikimit ligjor dhe rregullimit në aktin nënligjor përkatës të sipërpërmendur, nisur nga gjetjet në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet se nga ana e drejtuesve të zyrave si personat përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e shpërndarjes së çështjeve, është treguar kujdes në zbatimin e rregullit të përgjithshëm të përdorimit të shortit.

### **Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm**

Përdorimin e shortit elektronik e gjejmë të zbatuar si rregull në të gjitha zyrat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë ku është mundësuar nëpërmjet sistemit CAMS, i cili rezulton të ketë qenë funksional në këto zyra.

Shortimi elektronik referuar udhëzimit është përdorur, sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm gjerësisht për çështjet – kallëzim/referimet penale, përveç zyrës Tiranë e cila ka përdorur këtë mënyrë të proceduari edhe për çështjet – dosjet e ardhur për kompetencë dhe referime/hetime pasurore. Për këto të fundit, dhe për çështje të tjera si ato të lidhur me fushën e ekzekutimeve të vendimeve penale dhe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, si dhe me ato të kërkesave në gjykatë sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, në zyrat e tjera është proceduar kryesisht me shortin manual si alternativë e shortit elektronik e lidhur me pamundësinë e sistemit CAMS për të përfshirë në short elektronik të gjitha llojet e çështjeve që për shkaqe të regjistrimit në regjistra të veçantë mbartnin të njëjtin numër. Ndodhur përpara kësaj problematike të funksionimit të sistemit CAMS, për çështjet e referimit pasuror nga dy prej zyrave, Shkodër dhe Gjirokastrë është proceduar me regjistrimin e këtyre çështjeve në regjistrin e kallëzimeve penale për të proceduar më pas në shortimin elektronik, ndërsa për çështjet e ardhur për kompetencë në pjesën më të madhe të zyrave ku edhe ka patur raste, është proceduar me regjistrimin e këtyre çështjeve në regjistrin e kallëzimeve penale për të proceduar më pas në shortimin elektronik.

Përdorimi i shortit manual në rastet e sipërpërmendura, referuar informacionit të përcjellë dhe në konsideratat kryesisht të llojit të çështjeve të përfshira në këto shortime që e bënë të pamundur përdorimin e sistemit CAMS për shortin elektronik, vlerësohet si një mënyrë e menaxhimit të drejtuesit të zyrës bazuar në parashikimin e rregullave të detajuara të procedurës së shpërndarjes së çështjeve në funksion të transparencës dhe garantimit të një raportit të drejtë të caktimit të çështjeve ndërmjet prokurorëve. Në këtë vlerësim, konkludohet duke patur në vëmendje edhe vijimin e punës për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, referuar raportit vjetor mbi ngarkesën e punës për vitin 2023

të Prokurorit të Përgjithshëm. “3.1 Me miratimin e paketës së ndihmës financiare nga Bashkimi Evropian lidhur me implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, grupi i punës i ngritur nga Prokurori i Përgjithshëm do të vijojë aktivitetin në bashkërendim me shoqërinë që do të ndërtojë sistemin dhe subjekte të tjera të rëndësishme në proces, për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes që mundëson dixhitalizimin e plotë të proceseve të punës, gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme në kohë reale, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe çdo kërkesë të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore. 3.3 Të vijojë me tej puna e nisur dhe e papërfunduar nga Projekti Euralius V për zhvillimin dhe përfundimin e sistemin elektronik PRESTO, për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave me të dhëna në kohë reale dhe gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në këtë periudhë të ndërmjetme/tranzitore, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të ri CAMS.”.

Në këto kushte në konsideratat e mundësisë së ngritjes së problematikave të sistemit të konstatuara gjatë kryerjes së këtij inspektimi, vlerësohet të ndiqet si çështje në kushtet kur procedura e shpërndarjes së çështjeve i nënshtrohet inspektimit periodik nga ILD, referuar parashikimeve ligjore të ligjit organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë.

Shortimi elektronik, në të gjitha zyrat është realizuar kryesisht brenda ditës së regjistrimit të materialeve. Në rastet kur janë evidentuar vonesa më shumë se një ditë, është vlerësuar në raport me përjashtimin nga rregulli sipas Udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2016, mbështetur në arsyet e ardhjes së materialit në orët e vona të orarit zyrtar të ditëve të premtë, jashtë orarit zyrtar, në ditët përpara ditëve të pushimeve zyrtare, volumit të lartë të punës, apo për shkak të mosfunksionimit të sistemit elektronik. Nga këto raste, janë evidentuar edhe vonesa tej afatit të arsyeshëm, të vlerësuar si të tillë në një marzh kohor ditor referuar përjashtimit të sipërpërmendur dhe në konsideratat e një raporti të konsiderueshëm të numrit të çështjeve në tërësi të regjistruar në atë zyrë prokurorie për periudhën objekt inspektimi. Për këto raste, të evidentuar në zyrat Tiranë dhe Vlorë, është vlerësuar kryerja e verifikimeve të mëtejshme, sipas parashikimeve të ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar.

Ndjekja e rregullit të përgjithshëm të shortit për shpërndarjen e çështjeve në zyrat e prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm të shkallëve të para të inspektuara, është shoqëruar edhe me përjashtimet referuar parashikimeve përkatëse të udhëzimit nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm. Në të gjitha këto zyra për çdo muaj nga drejtuesi i prokurorisë procedohej me nxjerrjen e grafikut të gatishmërisë, bazuar në të cilën bëhej edhe shpërndarja e materialeve të referuara për hetim pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare; referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme ku përfshihen edhe ato me arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë.

Shpërndarja e çështjeve bazuar në listën e gatishmërisë në të gjitha zyrat e inspektuara ka përfshirë përveç kallëzimeve/referimeve penale të parashikuara shprehimisht në udhëzimin

në fjalë, edhe çështje të tjera, të tilla si referime pasurore, çështje të lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja me qëllim ekstradimin, si dhe ato lidhur me letërporositë. Përfshirja edhe e këtyre çështjeve vlerësohet se është në përputhje me parimin e përgjithshëm të parashikuar në ligj, sipas të cilit çdo çështje e cila duhet të trajtohet nga një prokuror do të duhet t'i nënshtrohet ndarjes rastësore ndërmjet prokurorëve të një zyre për të garantuar kështu, jo vetëm një raport të drejtë të ngarkesës së punës, por edhe transparencë në veprimtarinë e një zyre prokurorie.

Mënyra përjashtimore e të proceduarit me anë të listës së gatishmërisë është përdorur sikurse në periudhën e inspektimit të mëparshëm, edhe në periudhën objekt i këtij inspektimi, nga disa zyra edhe në periudhën e gushtit, që lidhet me marrjen e lejes vjetore nga ana e të gjithë prokurorëve, ndërsa nga disa zyra të tjera kallëzimet/referimet penale të regjistruara në këtë periudhë dhe për të cilat nuk kanë paraqitur nevojën e veprimeve të menjëhershme/arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë, është proceduar me ndjekjen e rregullimit të zakonshëm të shortit elektronik në shtator. Kjo praktikë e fundit, nuk parashikohet si e tillë në udhëzimin për shpërndarjen e çështjeve në prokurori, por në zyrat që është ndjekur nga disa prej tyre është arsyetuar lidhur me pamundësinë e prokurorëve për të trajtuar çështje të tilla brenda afateve procedurale për shkak të të qenit me leje vjetore dhe disa të tjerë kanë shtuar edhe mungesën e infrastrukturës për hedhjen në short dhe dorëzimin e çështjeve tek prokurorët. Një praktikë e tillë, siç kemi theksuar edhe në inspektimin e mëparshëm, ndonëse e arsyetuar vlerësohet se duhet të gjejë rregullim në përputhje me parashikimet procedurale të trajtimit të një çështje që regjistrohet në prokurori. Nga njëra prej zyrave, si Vlora ku është evidentuar kjo praktikë në inspektimin e mëparshëm, referuar informacionit të përcjellë në kuadër të rekomandimeve, është theksuar se do të ndryshohet duke proceduar me shpërndarjen e çështjeve që nuk kërkojnë veprime të menjëhershme, sipas listës së gatishmërisë.

Lidhur me praktikën e shpërndarjes së çështjeve të regjistruara në periudhën gusht dhe për të cilat nuk kërkohet kryerja e veprimeve të menjëhershme/arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë, duke pezulluar shortin elektronik apo shpërndarjen e tyre sipas gatishmërisë, duhet të evidentohet edhe një praktikë tjetër sipas të cilit nuk pezullohet shorti elektronik. Kjo mënyrë e të proceduarit është evidentuar në zyrën Fier, ku është proceduar sipas një urdhri me shkrim për shpërndarjen e këtyre lloj çështjeve me short elektronik ndërmjet prokurorëve që janë në punë.

Gjithashtu lidhur me përjashtimin e parashikuar për çështjet tashmë për të cilat vendosej rifillimi i ndjekjes penale dhe për ato të filluara kryesisht nga prokurori, në të gjitha zyrat e inspektuara është konstatuar zbatimi i parashikimeve përkatëse. Lidhur me këto përjashtime, është konstatuar se në ato zyra ku ka patur raste të identifikimit paraprakisht të një kallëzimi/referimi penal të njëjtë në objekt me një tjetër të këtyre lloj çështjeve të regjistruar më parë dhe për të cilat është proceduar rregullisht me caktimin e çështjeve, nga ana e drejtuesve të zyrave është ndjekur praktika e kalimit të tyre prokurorit të caktuar për çështjen e mëparshme. Ndjekja e kësaj praktike është bazuar në arsyetimin e shmangies së disa hetimeve njëkohësisht për të njëjtin fakt.

Përveç ndjekjes së rregullimit të përgjithshëm të shortit dhe përjashtimeve nga ky rregull, të cilat parashikohen shprehimisht në udhëzimin me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, konstatohet edhe në këtë periudhë inspektimi, ndjekja e praktikës së caktimit të çështjeve nga drejtuesi i zyrës, që rezulton rast pas rasti dhe e pambështetur në ndonjë rregullim bazuar në kriterë mirëpërcaktuar. Këto caktime lidhen kryesisht me marrjen nga vetë drejtuesi të çështjeve – kallëzim/referim penal për t’u ndjekur, apo caktimin prej drejtuesit të prokurorëve, siç ka ndodhur në zyrat Lezhë, Berat, Korçë, Shkodër, Sarandë, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë.

Lidhur me këtë mënyrë të proceduari përse i përket çështjeve, kryesisht kallëzime, të marra për trajtim nga vetë drejtuesi i zyrës, nuk konstatohet se mbi çfarë kriteri drejtuesi përzgjedh një çështje të caktuar për t’a trajtuar, ndonëse rezultonte se në këto zyra kryesisht drejtuesi ishte i gatshëm gjatë gjithë ditëve të vitit. Sipas parashikimeve të udhëzimit me nr. 3/2016, drejtuesi i zyrës së prokurorisë në kuadër të kompetencave të tij të drejtimit dhe mbikëqyrjes së procedurës për shpërndarjen e çështjeve, mund të mos i kalojë të gjitha çështjet e parashikuara për t’u ndjekur nga prokurori i gatshëm, kur vlerëson se është një numër i madh çështjesh të tilla. Për këto të fundit kur nuk i kalohen prokurorit të gatshëm, në udhëzim nuk parashikohet diskrecion i drejtuesit për mënyrën e caktimit, por nënshtrimi i tyre procedurës së shortit.

Në inspektimin e mëparshëm, lidhur me rastet e evidentuara, është theksuar se vlerësohet e rëndësishme në kushtet kur vetë drejtuesi është i gatshëm dhe si i tillë mund të marrë ngarkesë si një prokuror çështje, duhet që të parashikohet një rregullim i veçantë, për të mos lënë vend *‘edhe në dukje se përzgjedh ndërmjet çështjeve’*. Në funksion të këtij rregullimi, vlerësohet normimi që Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet Udhëzimit me nr. 8 datë 23.07.2024 “Për efektivitetin e Shërbimit të Gatishmërisë”, i ka bërë përfshirjes në gatishmëri të drejtuesit të zyrës. Lidhur me këtë rregullim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vendimin me nr. 65, datë 10.04.2025 *“Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit ..., me detyrë drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ...”*, e ka konsideruar si një kufizim të përfshirjes së drejtuesit dhe me qëllim për të shmangur pikërisht përqendrimin e çështjeve në një figurë të vetme dhe për të siguruar një trajtim të drejtë, proporcional dhe të monitorueshëm të tyre<sup>20</sup>. Në këtë vendim, gjithashtu është pranuar mungesa e diskrecionalitetit të drejtuesit për mënyrën e caktimit të evidentuar si më sipër, edhe në inspektimin e mëparshëm, duke u shprehur se: *“... Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, i ndryshuar, ashtu edhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, nuk i njohin të drejtën Drejtuesit të Prokurorisë që të vendosë apriori në çdo rast vetën si prokuror i gatshëm dhe për më tepër, të vendosë vetë se cilat çështje do të mbajë apo jo, në këto raste. .... qënia i gatshëm apo marrja e çështjeve nga drejtuesi pa një bazë ligjore konkrete apo jashtë shortit nuk mund të justifikohet me “praktikë”, “arsyetim të brendshëm” apo “nevojë institucionale” sepse nuk mbështetet në një dispozitë ligjore eksplicite dhe si e tillë çënohet parimi i shtetit të së drejtës dhe ndarja e kompetencave”*.

<sup>20</sup> Shiko faqen 47 të vendimit në fjalë.

Në rastet e evidentuara në zyrat referuar të dhënave të marra në funksion të këtij inspektimi në drejtim të arsyeve të të proceduarit në këtë mënyrë, të kallëzimeve të marra nga vetë drejtuesi, mund të veçohen dy raste të zyrës Sarandë ku nga ana e drejtuesit është arsyetuar me “*marrjen përsipër të hetimeve*” për shkak të mosgjetyes së bashkëpunimit të prokurores së gatshme/apo mosveprimin e prokurorit të gatshëm. Një nga këto raste, të marrjes përsipër të hetimit nga drejtuesi i zyrës mbështetur në arsyetimin e mosveprimit të prokurorit të gatshëm, është trajtuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vendimmarrjen me nr. 65, datë 10.04.2025 të sipërpërmendur duke e konsideruar shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronja “I” e ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, me arsyetimin se: “238. Bazuar në të dhënat faktike të administruara gjatë hetimit disiplinor, kuadri ligjor në fuqi, udhëzimet përkatëse të Prokurorit të Përgjithshëm dhe mbi të gjitha, në dritën e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, të ndërmarra në kuadër të Reformës në Drejtësi, rezulton se sjellja e magjistratit \*\*\* përbën shkelje disiplinore të qartë dhe të provuar. 239. Në qendër të këtij konkluzioni qëndron mënyra se si ai ka ndërhyrë drejtëpërdrejt në trajtimin e dy materialeve kallëzuese gjatë periudhës kur në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar prokurorja \*\*\* ka qenë prokurore e gatshme. Në të dyja rastet – për materialin kallëzues ... dhe për materialin ... – janë konstatuar shkelje të procedurës së caktimit të prokurorit të çështjes. ... 241. ... ndërhyrja e \*\*\* për të marrë vetë në trajtim materialet kallëzuese në dy raste të ndara, pa ndjekur procedurat e shortit dhe pa u bazuar në ndonjë arsye ligjore të justifikuar, përbën një cënim të kompetencave dhe të pavarësisë funksionale të prokurores, e cila në të dy rastet rezulton të ketë qenë legjitimisht në detyrë sipas grafikut të miratuar të gatishmërisë. 242. Më tej, argumenti i ngritur nga subjekti i hetimit, sipas të cilit ai ka ushtruar kompetencën për të marrë përsipër trajtimin e çështjes bazuar në autoritetin e drejtuesit, nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor të pas vitit 2016. ... 243. Për më tepër, nuk ka asnjë të dhënë që të provohet se në të dyja rastet ekzistonte ndonjë rrethanë që ta justifikonte tejkalimin e prokurores së gatshme. ...244. E rëndësishme është gjithashtu që në të dy rastet, veprimet e Drejtuesit janë kryer pa dokumentacion mbështetës që të tregojë një analizë paraprake të justifikimit të përfshirjes së tij në trajtim të çështjeve, duke shkelur në këtë mënyrë edhe parashikimin e monitorueshmërisë dhe verifikueshmërisë së veprimeve të brendshme në sistemin prokurorial, siç kërkohet nga neni 53 i ligjit nr. 97/2016. ... 248. Pretendimet e ngritura nga magjistrati \*\*\* që kishin të bënin me menaxhimin e çështjeve me efikasitet, dyshimi i mënyrës së trajtimit të tyre nga ana e prokurores znj.\*\*\*, dukshëm nuk qëndrojnë. ... 254. Për sa më sipër, në vlerësim të gjithë fakteve objekt shqyrtimi disiplinor dhe provave të administruara, rezultoi e provuar që shkelja disiplinore, mospërmbyllje nga ana e Drejtuesit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti e detyrave që lidhen me sistemin e menaxhimit të çështjeve të jetë kryer nga magjistrati \*\*\* , në cilësinë e Drejtuesit të Zyrës së Prokurorisë. Gjithashtu, vërtetohet edhe përgjegjësia disiplinore e Drejtuesit në këtë rast, pasi provohet prezenca dhe uniteti i elementeve objektivë dhe subjektivë, të cilët lidhen me figurën e shkeljes disiplinore. 255. Në vlerësimin e Këshillit, ndjekja e një praktike të tillë pune nga Drejtuesi i Prokurorisë, në rastet e gatishmërisë së prokurorëve të tjerë dhe ndërhyrja e tij kur nuk është e domosdoshme, pavarësisht motivit, cënon mirëfunksionimin e vet zyrës së prokurorisë dhe përbën shkelje

të detyrave që lidhen me sistemin e menaxhimit të çështjeve”, në referim të nenit 102, pika 1, shkronja “l” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”. Ndërsa për rastin tjetër, jemi në kushtet kur drejtuesi i zyrës nuk gëzon më statusin për shkak të vendimit të KPA-së, dhe për këtë arsye nuk mund të procedohet më tej, sipas ligjit me nr. 97/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me rastet e tjera të caktimit të çështjes nga drejtuesi për t’u trajtuar nga ana e tij, në të njëjtën zyrë prokurorie dhe në zyrat e tjera të evidentuara, nuk evidentohen të dhëna referuar faktit objekt trajtimi nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vendimarrjen sa më sipër, të cilat do të referonin në drejtim të inicimit të procedurave disiplinore. Konstatimet në këtë inspektim, të njëjta sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm do të mbahen në konsideratë në mënyrën e të proceduarit në vazhdimësi të këtyre zyrave, apo të zyrave të tjera kur do të vlerësohet veprimtaria e drejtuesit në drejtim të përgjegjësisë disiplinore. Në mbajtjen e këtij qëndrimi mbahet në konsideratë edhe se gjetjet e inspektimit të mëparshëm ku u evidentuan të njëjtat të dhëna për të cilat është konkluduar në rekomandimet përkatëse, ndjekja e tyre nuk përfshihen në periudhën objekt i inspektimit aktual dhe ndërkohë konstatohet se propozimet në këtë drejtim në inspektimin e mëparshëm kanë gjetur rregullim, nëpërmjet udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe mandej edhe me qëndrimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke e bërë më të qartë, referuar rastit, kompetencën e drejtuesit të zyrës së prokurorisë për caktimin e çështjeve në prokurori duke garantuar shpërndarje të drejtë dhe të paanshme. Vlen të theksohet karakteri njohës dhe konstatues, si qëllim parësor për të cilën është vendosur kryerja e këtij inspektimi, pa anashkaluar edhe identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjellje të magjistratëve të cilët në bazë të një dyshimi të arsyeshëm do të justifikonin fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në të njëjtat konsiderata, edhe përsa i përket caktimit të materialit kallëzues nga vetë drejtuesi tek një prokuror, në momentin e hyrjes/protokollimit të tij dhe në kushtet kur nuk ka një urdhër të mëparshëm në kuadër të organizimit të zyrës, ashtu sikurse është konstatuar në inspektimin e mëparshëm kjo mënyrë e të proceduarit nuk është e parashikuar si një mundësi e drejtuesit, në rregullimin e normuar në udhëzimin me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm. Në kuadrin e organizimit të zyrës, në kushtet e mungesës për arsye objektive të prokurorit të gatshëm në ditën e caktuar, drejtuesi i zyrës i ka të gjitha mundësitë që të procedojë me akt të shkruar për zëvendësimin e prokurorit. Për rrjedhojë, ashtu sikurse është theksuar në inspektimin e mëparshëm, vlerësohet dokumentimi i ndryshimeve të tilla në ditët e gatishmërisë për të bërë të mundur në vazhdim, edhe verifikimin e ndjekjes së rregullimit sipas udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për caktimin e çështjeve. Në rastet e caktimit të materialit kallëzues të prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë, në momentin e hyrjes/protokollit të tij dhe në kushtet kur nuk ka një urdhër të mëparshëm në kuadër të organizimit të zyrës, mund të veçohen ato të evidentuar në zyrën Berat, kur nga ana e drejtuesit të kësaj zyre është proceduar me caktimin e kallëzimeve me të mitur një prokurori, ndërkohë që ishte ngritur seksioni përkatës i përbërë nga tre prokurorë që bënte të mundur procedimin me anë të shortit elektronik, sipas udhëzimit të Prokurorit të

Përgjithshëm. Në këto kushte, për këto raste, 21 të tilla është vlerësuar kryerja e verifikimeve të mëtejshme referuar procedurave disiplinore sipas ligjit me nr. 97/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përsa i përket rasteve të caktimit të çështjeve në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe në kuadër të nenit 59 të K.P.Penale, të gjitha këto çështje ashtu sikurse nga inspektimi i mëparshëm, u konstatuan se caktoheshin me anë të siglimit nga ana e drejtuesit të seksionit në zyrën Tiranë. Kjo mënyrë të proceduari është evidentuar edhe në disa zyra si Gjirokastrë, Lezhë, Kukës, Berat, Shkodër, veçanërisht për çështjet në kuadër të nenit 59 të K.pr.penale. Në kushtet, kur sistemi CAMS nuk e mundëson shpërndarjen e këtyre çështjeve siç është referuar nga kjo zyrë, do të vlerësohet përdorimi i shortit manual si një alternativë e parashikuar në udhëzimin nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm për shpërndarjen e çështjeve në prokurori, ashtu siç është evidentuar se është proceduar në disa zyra. Për këtë procedurë do të duhet të jemi edhe në kushtet kur tashmë çështja në fjalë nuk është trajtuar më parë nga një prokuror tjetër, pasi në të kundërt rasti do të duhet t’i kalohet prokurorit që e ka trajtuar.

Referuar informacionit të marrë nga zyrat objekt i këtij inspektimi është konstatuar se nga ana e drejtuesve të zyrës, në kuadër të garantimit të një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve, është proceduar me përjashtimin e prokurorëve të caktuar nga shorti. Kjo mënyrë e të proceduari është parashikuar shprehimisht në udhëzimin me nr. 3/2016, por lidhur me këtë janë përcaktuar rastet se kur mund të veprohet. Rasti i përdorur gjerësisht nga zyrat është numri i çështjeve të caktuar një prokurori të thjeshtë e cila është vlerësuar si ngarkesë pune e madhe e prokurorit, ndërsa në rastin e zv/drejtuesit është arsyetuar edhe lidhur me punën administrative të ngarkuar për t’u kryer nga ata. Gjithashtu për përjashtimin e prokurorëve nga shorti, është proceduar edhe me shkaqe të tjera të cilat sipas arsytimit, mund të përfshihen tek rasti “arsye të justifikuara” që parashikohet në udhëzimin e sipërpërmendur për shpërndarjen e çështjeve në prokurori.

Në përgjithësi në zyrat ku është aplikuar përjashtimi nga shorti i prokurorit, është proceduar me akt të shkruar dhe të arsyetuar nga ana e drejtuesit. Kjo është vënë re në këtë periudhë inspektimi, në ndryshim nga inspektimi i mëparshëm edhe në zyrën e Prokurorisë Tiranë.

Nga inspektimi i kryer, kryesisht në zyra të mëdha prokurorie u konstatua se drejtuesi i prokurorisë rezultonte në ngarkesë të ulët, referuar numrit të kallëzimeve/referimeve penale në krahasim me numrin e përgjithshëm të këtyre lloj çështjeve përgjatë periudhës objekt i këtij inspektimi. Në këto zyra kryesisht drejtuesit kanë marrë ngarkesë jo nëpërmjet shortit elektronik dhe madje nga drejtuesi i zyrës Vlorë është informuar se drejtuesi i prokurorisë nuk është i planifikuar në sistemin elektronik, por se ata përfshihen gjatë gjithë muajit në grafikun e gatishmërisë duke komunikuar e dhënë orientime për çështje të një rëndësie të veçantë si dhe duke marrë pjesë aktive. Ndërsa drejtuesi i zyrës Lezhë, ka informuar marrjen e çështjeve që kërkojnë kryerjen e veprimeve të menjëhershme si një zgjidhje në kuadër të menaxhimit të këtyre çështjeve e lidhur me funksionimin e sistemit CAMS, që nuk merr parasysh arsye të tjera objektive që mund të jenë shkak për përjashtimin e prokurorëve nga shorti elektronik, siç është kryesisht mungesa e prokurorit

në ditën e hedhjes së shortit dhe pamundësia e kryerjes së veprimeve të menjëhershme, por edhe ngarkesën e prokurorëve si një arsye tjetër që mund të sjellë pamundësi për kryerjen e veprimeve të menjëhershme, në kohën e duhur.

Lidhur me këtë konstatim në drejtim të ngarkesës, i njëjtë si edhe në inspektimin e mëparshëm, theksohet se në udhëzimin me nr.3/2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” është parashikuar se “*Drejtuesi i zyrës merr ngarkesë pune, në varësi të madhësisë së prokurorisë dhe ngarkesës së saj, në përputhje me rregullat e përgjithshme të këtij udhëzimi*”. Duke marrë në konsideratë, se prokurori në cilësinë e drejtuesit, ushtron përveç detyrës së prokurorit të çështjes edhe detyrën e drejtuesit referuar kompetencave të tij<sup>21</sup> si në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në atë të drejtimit administrativ të zyrës së prokurorisë, vlerësohet në drejtim të transparencës dhe garantimit të një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve, përcaktimi i disa kriterëve bazë që do të justifikonin reduktimin e ngarkesës së një drejtuesi, referuar numrit të kallëzimeve/referimeve penale që do të duhet të ndjekë e cila do të duhej të shoqërohej me akt të shkruar bazuar në procedurat e parashikuar në udhëzimin në fjalë për shpërndarjen e çështjeve. Zbatimi efektiv i saj do të kërkonte përcaktimin më parë të ngarkesës, numrit të çështjeve që duhet të trajtojë çdo prokuror brenda vitit sipas normës së punës në fuqi të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, siç është përcaktuar edhe në vendimin nr. 304 datë 19.09.2023 të “Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores “Përcaktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”. Sipas këtij vendimi, referuar raportit vjetor të KLP-së për vitin 2023, kjo normë nuk rezultoi të jetë përcaktuar ende në periudhën objekt i këtij inspektimi.

Gjithashtu në të njëjtat konsiderata edhe për zv/drejtuesin e disa nga zyrat e sipërpërmendur lidhur me ngarkesën e drejtuesit, i cili referuar ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorëve përfaqëson prokurorinë në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit, duke kryer detyrat e nevojshme si: për funksionimin e prokurorisë, për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët apo çdo detyrë tjetër të përcaktuar në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në drejtim të raportit të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve referuar të dhënave të sistemit elektronik, si një nga burimet kryesore ku është mbështetur kryerja e inspektimit në disa prej zyrave të mëdha të inspektuara, u vu se, sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm, se të dhënat e kallëzimeve përditësoheshin vazhdimisht kur bëheshin zëvendësime të prokurorit dhe si të tilla nuk mundësonin të dhënat fillestare të datës/emrit të prokurorit të caktuar për t'u vlerësuar në drejtim të shpërndarjes së çështjeve në një periudhë të caktuar.

Gjithashtu edhe lidhur me hedhjen e të dhënave elektronike lidhur me materialet me arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë, nuk u evidentuan të dhëna mbi datën e arrestit/ndalimit, të dhënat këto të rëndësishme në drejtim të identifikimit të marrjes së materialit nga

<sup>21</sup> Nenet 42, 43 dhe 52 të ligjit me nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

prokurori përkatës i gatshëm, në ato zyra që ndjekin praktikën e shpërndarjes duke marrë për bazë datën e arrestimit në flagrancë/ndalimi dhe prokurorin e gatshëm në datën përkatëse pavarësisht datës së hyrjes/protokollimit në prokurori. Lidhur me këtë moment, nga disa zyra referuar informacionit të përcjellë lidhur me rekomandimet e inspektimit të mëparshëm, por që nuk përkojnë me këtë periudhë inspektimi objekt i këtij raporti, janë marrë masa për të hedhur edhe këto të dhëna.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të shortimit elektronik CAMS në zyrat e inspektuara në drejtim të ruajtjes së raportit të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve, është konstatuar ngritja e problematikës nga drejtuesi i zyrës Lezhë në informacionin e dërguar në kuadër të këtij inspektimi, lidhur me çështjet që kërkojnë veprime të menjëhershme. Për këto çështje, është informuar se ndonëse mënyra primare për caktimin e tyre është shorti elektronik, sistemi CAMS me anë të të cilit realizohet shorti elektronik, nuk mundëson marrjen parasysh të arsyeve objektive që mund të jenë shkak për përjashtimin e prokurorëve, të tilla si mungesa e prokurorit në ditën e hedhjes së shortit si dhe ngarkesën e prokurorëve, duke shtuar këtu edhe faktorin kohë që kërkohet për përjashtimin nga shorti referuar faktit se sistemi CAMS menaxhohet nga Drejtoria e IT në Prokurorinë e Përgjithshme. Për këtë, drejtuesi i zyrës ka proceduar me marrjen përsipër të këtyre lloj çështjesh, si një zgjidhje në drejtim të menaxhimit sa më të mirë të tyre.

Lidhur me funksionimin e sistemit CAMS, në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2023, është theksuar se: *“Prokuroria e Përgjithshme e ka konsideruar thelbësor për rritjen e eficiencës së punës, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjes. Në objektivat e institucionit tonë dhe në kërkesat për bashkëpunim për ndërtimin e këtij sistemi, është krijimi i një sistemi që mundëson dixhitalizim të plotë të proceseve të punës, gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, ndër lidhje me baza të dhënash e çdo kërkesë të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore. Për këtë qëllim, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 04 datë 09.01.2023 u ngrit grupi i punës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes. ...*

*Lidhur me kërkesën për shpërndarjen elektronike të çështjeve, aktualisht në zbatim të kriterëve ligjore dhe përcaktimeve të udhëzimit nr. 3/2016, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i ndryshuar, prokuroria siguron që nëpërmjet përdorimit të sistemit CAMS të realizohet ndarja e rastësishme e çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke siguruar transparencë në shpërndarjen e çështjeve dhe garantim të pavarësisë e paanshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, edhe nëpërmjet këtij procesi. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit nr. 3/2016, si nëpërmjet kërkesave për informacion ashtu dhe nëpërmjet monitorimit të sistemit CAMS, me qëllim mbështetjen teknike të prokurorëve. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, shorti elektronik përdoret sistematikisht në bazë të regjistrimeve të kallëzimeve/referimeve që kryhen gjatë një dite, të cilat shortohen mes prokurorëve të seksionit ose prokurorisë përkatëse, sipas rastit. Shorti kryhet automatikisht*

*sapo bëhet regjistrimi i kallëzimit/referimit penal në sistem, i cili nëpërmjet një algoritmi përzgjedh prokurorin në mënyrë të rastësishme, duke pasur parasysh dhe ngarkesën e prokurorëve të tjerë të seksionit apo të një prokurorie me numër të vogël prokurorësh, në rastet e prokurorive ku nuk ka seksione. Sistemi i ndan në numër të barabartë kallëzimet/referimet penale të regjistruara brenda një seksioni apo prokurorie të caktuara brenda një dite”.*

Puna për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes, ka vijuar edhe përgjatë vitit 2024 sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për këtë periudhë, ku është informuar se: “shprehet se: “Sistemi i ri i Menaxhimit të Çështjeve në prokurori, do të mbështetet nga Bashkimi Evropian. Për këtë qëllim, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 04 datë 04.01.2024 ngriti grupin e punës me ekspertë prokurorë nga të gjithë nivelet e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim për sigurimin e mbështetjes së nevojshme në krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes. Në muajin tetor 2024 është nënshkruar marrëveshja midis BE-së dhe UNOPS-it për implementimin e sistemit CAMS dhe komponentëve të tjerë që lidhen me këtë sistem. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të UNOPS dhe grupit të punës. Në takimin e zhvilluar në datë 05.11.2024 u prezantuan fazat dhe afatet e projektit, duke nisur kështu formalizimi i bashkëpunimit dhe punës së përbashkët për ndërtimin dhe implementimin e këtij sistemi të rëndësishëm. Prokuroria e Përgjithshme ka siguruar angazhim të plotë për të adresuar të gjitha nevojat tona për një sistem efikas dhe mbështetje në plotësimin e kërkesave të tjera të nevojshme për implementimin e projektit.”

## **Zyra e apelit**

Në zyrën e apelit, duke përfshirë këtu edhe periudhën përkatëse përpara riorganizimit, e përfshirë në periudhën e inspektimit<sup>22</sup>, bazuar në udhëzimin me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” është konstatuar kryesisht ndjekja e rregullit të përgjithshëm të të proceduarit me anë të shortit për shpërndarjen e çështjeve, përveç zyrës Gjyrokastër ku për shkak të ushtrimit të detyrës të një prokurori nuk është bërë e mundur ndjekja e një rregulli të tillë.

Procedura e shortit e sipërpërmendur e zbatuar në zyrën e apelit, udhëzimit me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, është ajo e shortimit manual, sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm. Nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit të sjellë nga Prokuroria e Përgjithshme për efekt të këtij inspektimi, nuk ka qenë i implementuar hedhja e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS. Nga

<sup>22</sup> Periudha e inspektimit ka përfshirë një periudhë kohe prej 1 muaji, të veprimtarisë së ish zyrares të Prokurorisë të Apelit, të cilat për shkak riorganizimi në kuadër të hartës gjyqësore, me datën 01.02.2023 kanë ndërprerë veprimtarinë dhe kanë pushuar së ekzistuari, duke u vazhduar funksionimi i shkallës së apelit të prokurorisë, nën emërtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në Tiranë.

raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit të Prokurorisë së Përgjithshme, i vitit 2023, i sipërpërmendur është raportuar për shortimin elektronik nëpërmjet sistemit CAMS vetëm për zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallëve të para, duke u shprehur edhe për vijimin e masave lidhur me ngritjen e sistemit të ri të Menaxhimit të çështjeve në prokurori. Ky raportim është bërë në funksion të zbatimit të rekomandimit nr. 3 të Rezolutës së Kuvendit për Prokurorinë e Përgjithshme, që përkon edhe me rekomandimin prioritar 1 në drejtimin I të vendimit të Këshillit të Ministrave. Masat kanë vazhduar edhe në vitin 2024, referuar raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, ku është vendosur si objektiv edhe për vitin 2025 *“Të vijojë sigurimin e bashkëpunimit për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes që mundëson dixhitalizimin e plotë të proceseve të punës, gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme në kohë reale, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe çdo kërkesë të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore.”*.

Në drejtim të shortit, në analizën vjetore të punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2023, është theksuar se: *“... rëndësi ka marrë respektimi i procesit të shortimit të dosjeve, duke patur në konsideratë një shpërndarje të drejtë jo vetëm në numër, por edhe në vepra penale, element ky që është respektuar nga ana e drejtuesit prokurorisë.”*.

Nga të dhënat e marra, është konstatuar se nga zyra e apelit, në zbatim të parashikimeve të udhëzimit të sipërpërmendur është proceduar me përjashtimin nga caktimi të çështjeve për të cilat kishte patur një gjykim të mëparshëm dhe që për të cilat ishte caktuar prokurori, si dhe duke ia kaluar këtij prokurori çështjen e radhës.

Rregulli i përgjithshëm i shpërndarjes së çështjeve me anë të shortit është ndjekur kryesisht për çështjet e themelit, ndërsa për masat e sigurimit është proceduar kryesisht me shpërndarjen e çështjeve referuar listës së gadishmërisë.

Për pasqyrimin e shpërndarjes së çështjeve është konstatuar mbajtja e regjistrave përkatës të ndarë në çështje themeli dhe masa siguri. Në formatin e regjistrave të mbajtur nga kjo zyrë prokurorie është evidentuar, ashtu sikurse edhe në inspektimin e mëparshëm të vitit 2022, se nuk rezultonte i pasqyruar data e hyrjes në prokurori të njoftimit nga gjykata për zhvillimin e një gjykimi, e konsideruar e rëndësishme në drejtim të identifikimit të qartë të shpërndarjes së çështjes si në drejtim të procedurës së shortit ashtu edhe sipas gadishmërisë. Nga kjo zyrë, referuar informacionit të përcjellë lidhur me inspektimin e mëparshëm, ndonëse periudha e zbatimit të rekomandimeve të të cilit nuk përfshihen në periudhën objekt inspektimi, nuk evidentohen të dhëna të reja në këtë drejtim.

### **Prokuroria e Përgjithshme**

Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme është proceduar me caktimin e prokurorit me short manual, sikurse edhe në periudhën objekt i inspektimit të mëparshëm. Ashtu sikurse, e përmendëm edhe më sipër, në raportet vjetore të Prokurorit të

Përgjithshëm është raportuar për shortimin elektronik nëpërmjet sistemit CAMS vetëm për zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallëve të para, duke u shprehur edhe për vijimin e masave lidhur me ngritjen e sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve në prokurori në zbatim të rekomandimeve. Shpërndarja e çështjeve me anë të shortit manual bëhej ndërmjet prokurorëve të Drejtorisë Gjyqësore dhe në rastet e mbingarkesës, nëpërmjet urdhrave të veçantë të Prokurorit të Përgjithshëm urdhërohen prokurorë të një drejtorie tjetër të mbështesin këtë drejtori sipas nevojave.

### **Prokuroria e Posaçme**

Për këtë zyrë prokurorie referuar ligjit organik të organizimit dhe funksionimit të tij, në nenin 15 pika 2 shkronja "b" është parashikuar se u cakton çështje prokurorëve të posaçëm bazuar në specializimin e tyre.

Lidhur procedurën e shpërndarjes së çështjeve, në Raportin vjetor të vitit 2023 është theksuar në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, edhe ndihma lidhur me kryerjen e procesit të zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve. Për këtë proces theksohet se: *"... përgjatë vitit 2023 ka qenë në zhvillim dhe është ofruar si ndihmë nga ICITAP. ... Është parashikuar që ky sistem të jetë funksional gjatë vitit 2024. ... Implementimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e punës së përditshme dhe rritjen e transparencës në trajtimin e çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. ... Kërkesat themelore të funksionimit që do të përmbushen nga sistemi duke përfshirë në mënyrë modulare gjithë sektorët janë si më poshtë: ... Vlerësimi, shortimi elektronik për caktimin e prokurorit që do të ndjekë çështjen. ...".* Në vazhdim në Raportin vjetor të vitit 2024, në kuadër rekomandimi, është raportuar *"Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve. Objekti i përgjithshëm është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të gjitha çështjeve të trajtuara nga SPAK, krijimin e një regjistrimi elektronik/bazë të dhënash, i cili mundëson ndjekje dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Prokurorëve, Hetuesve të BKH, zyrës së regjistrimit, komunikimin me gjykatën dhe analizimin e këtij informacioni, për të nxjerrë raporte dhe statistika të sakta dhe në kohë reale. ... Brenda vitit 2025 parashikohet të përfundojë vënia në funksion edhe e moduleve të tjera, si raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letërporosive, si dhe të fillojë zbatimin e sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve"*

Në kuadër të këtij inspektimi, nga zyra e prokurorisë në fjalë është marrë informacioni i nevojshëm lidhur me procedurën në fjalë, në drejtim të mënyrës së shpërndarjes së çështjeve, objekt i këtij inspektimi. Referuar këtij informacioni konstatohet zbatimi i procedurës së shortit manual dhe atij të bazuar në nenin 15 pika 1 shkronja "b" e ligjit organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë së Posaçme, në respektim të garantimit të parimit të transparencës në shpërndarjen e çështjeve ndërmjet prokurorëve nga njëra anë dhe të trajtimit të çështjes sipas specialitetit të prokurorit nga ana tjetër që

garanton raport të drejtë të shpërndarjes së çështjeve e lidhur ngushtë me natyrën dhe kompleksitetin e çështjes.

#### IV. Konkluzione

- Në zyrat e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të inspektuara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, për shpërndarjen e çështjeve kryesisht është përdorur si rregull shorti elektronik dhe si përjashtim sipas rasteve të përfshirë në udhëzimin me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

Me short elektronik në këto zyra është proceduar nëpërmjet sistemit CAMS, për shpërndarjen e çështjeve kryesisht të llojit – kallëzime/referime penale. Çështjet e tjera të cilat regjistroheshin në regjistra të ndryshme nga ato të kallëzimeve/referimeve penale nuk mund të shortheshin nëpërmjet sistemit CAMS për shkak se nuk përfshiheshin në opsionet e këtij sistemi. Në këto kushte për këto çështje është përdorur kryesisht shorti manual dhe në veçanti për shkak të organizimit të një zyre e lidhur me organikën efektive të prokurorëve, i janë kaluar prokurorit të caktuar me urdhër të drejtuesit për ndjekjen e këtyre lloj çështjeve.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të shortimit elektronik CAMS në zyrat e inspektuara, në përgjithësi nuk janë ngritur problematika. Shortimi elektronik, në të gjitha zyrat është realizuar kryesisht brenda ditës së regjistrimit të materialeve. Në rastet kur janë evidentuar vonesa më shumë se një ditë, është vlerësuar në raport me përjashtimin nga rregulli sipas Udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2016, mbështetur në arsyet e ardhjes së materialit në orët e vona të orarit zyrtar të ditëve të premte, jashtë orarit zyrtar, në ditët përpara ditëve të pushimeve zyrtare, volumit të lartë të punës, apo për shkak të mosfunksionimit të sistemit elektronik. Nga këto raste, janë evidentuar edhe vonesa tej afatit të arsyeshëm, të vlerësuar si të tillë në një marzh kohor ditor referuar përjashtimit të sipërpërmendur dhe në konsideratat e një raporti të konsiderueshëm të numrit të çështjeve në tërësi të regjistruar në atë zyrë prokurorie për periudhën objekt inspektimi. Për këto raste, të evidentuar në dy zyrat, është vlerësuar kryerja e verifikimeve të mëtejshme, sipas parashikimeve të ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar.

Lidhur me rastet përjashtimit të të proceduarit me short, në të gjitha zyrat ku ka pasur raste, është proceduar edhe për çështjet për të cilat evidentohet se ka të njëjtin fakt /lidhje me faktin për cilën ka një kallëzim të regjistruar më parë dhe caktuar një prokurori. Për këto çështje ndonëse jo e parashikuar shprehimisht në udhëzim, bazuar në arsyetimin e shmangies së disa hetimeve njëkohësisht për të njëjtin fakt, është proceduar nga drejtuesi duke ia kaluar të njëjtit prokuror që ishte duke ndjekur çështjen e parë.

Për periudhën e gushtit, periudhë kur kryesisht prokurorët marrin lejen vjetore të parashikuar në ligj, është konstatuar ndjekja e praktikave të ndryshme lidhur me shpërndarjen e çështjeve të regjistruar në këtë periudhë. Kështu disa zyra kryesisht për të gjitha kallëzimet/referimet penale të regjistruar në periudhën në fjalë kanë proceduar me

shpërndarjen e tyre sipas listës së gatishmërisë, ndërsa disa zyra të tjera veçanërisht zyra të mëdha kanë proceduar sipas listës së gatishmërisë vetëm për materialet/kallëzimet penale për të cilat kanë paraqitur nevojën e veprimeve të menjëhershme/arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë dhe për të gjitha të tjerat është proceduar me ndjekjen e rregullit të zakonshëm të shortit elektronik në shtator. Gjithashtu në një zyrë është evidentuar edhe një praktikë e tretë, për shpërndarjen e çështjeve të kësaj periudhe të cilat nuk kanë paraqitur nevojën e veprimeve të menjëhershme/arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë, duke u proceduar me short elektronik midis prokurorëve që ishin në punë.

Konstatimi i praktikave të tilla, kërkon rregullim në përputhje me parashikimet procedurale të trajtimit të një çështje që regjistrohet në prokurori, duke garantuar si garancinë e paanshmërisë, transparencës dhe ngarkesën nga njëra anë dhe të drejtën e prokurorit për leje. Pezullimi i shortit elektronik, i gjetur si zgjidhje nga disa zyra kryesisht të mëdha, nuk parashikohet si e tillë në udhëzimin për shpërndarjen e çështjeve në prokurori, por në zyrat që është ndjekur nga disa prej tyre është arsyetuar lidhur me pamundësinë e prokurorëve për të trajtuar çështje të tilla brenda afateve procedurale për shkak të të qenit me leje vjetore dhe disa të tjerë kanë shtuar edhe mungesën e infrastrukturës për hedhjen në short dhe dorëzimin e çështjeve tek prokurorët. Një praktikë e tillë, siç kemi theksuar edhe në inspektimin e mëparshëm, ndonëse e arsyetuar vlerësohet se duhet të gjejë rregullim në përputhje me parashikimet procedurale të trajtimit të një çështje që regjistrohet në prokurori.

Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori, është konstatuar në disa zyra të mëdha/të vogla edhe ndjekja e praktikës së caktimit të çështjeve nga drejtuesi i zyrës, që rezulton rast pas rasti dhe e pambështetur në ndonjë rregullim bazuar në kriteret të mirëpërcaktuara në drejtim të përzgjedhjes së çështjeve. Këto caktime lidhen kryesisht me marrjen nga vetë drejtuesi të çështjeve – kallëzim/referim penal për t'u ndjekur nga ana e tij, apo caktimin prej drejtuesit të prokurorëve për ndjekjen e një çështje. Mënyra e të proceduarit përsa i përket çështjeve, kryesisht kallëzime, të marra për trajtim nga vetë drejtuesi i zyrës, nuk gjen mbështetje në parashikimet e ligjit organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, dhe të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe si i tillë do të duhet të menaxhohet nga drejtuesi i cili drejton dhe mbikëqyr këtë proces. Gjithashtu caktimi nga drejtuesi i një prokurori në kushtet e mungesës për arsye objektive të prokurorit të gatshëm, mbështetur në parashikimet përkatëse të ligjit organik e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për mënyrën e shpërndarjes së çështjeve, do të duhet të shoqërohet me akt të shkruar për zëvendësimin e tij, si një mjet verifikimi të kësaj mënyre të proceduarit për shkaqe objektive. Ndërsa nuk vlerësohet e justifikueshme caktimi nga drejtuesi i një prokurori, për shkaqe apo arsye të tjera të cilat nuk janë të parashikuara në Udhëzimin të Prokurorit të Përgjithshëm, me nr. 03, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurorit”,

Për përjashtimin e prokurorëve nga shorti, nga zyrat e prokurorive të inspektuara është proceduar në të gjitha zyrat me akt të shkruar dhe të arsyetuar nga ana e drejtuesit, referuar parashikimit të udhëzimit me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe rregullores së brendshme standard të organizimit dhe funksionimit të zyrave të prokurorisë.

Në disa zyra prokurorie të inspektuara, u konstatua se drejtuesi i prokurorisë rezultonte në ngarkesë të ulët, referuar numrit të kallëzimeve/referimeve penale në krahasim me numrin e përgjithshëm të këtyre lloj çështjeve përgjatë periudhës objekt i këtij inspektimi. Në këto zyra kryesisht drejtuesit kanë marrë ngarkesë jo nëpërmjet shortit elektronik dhe madje nga drejtues të dy zyrave kjo lidhet me faktin e përfshirjes gjatë gjithë muajit në grafikun e gatishmërisë duke komunikuar e dhënë orientime për çështje të një rëndësie të veçantë e marrë pjesë aktive, apo duke marrë çështje që kërkojnë kryerjen e veprimeve të menjëhershme si një zgjidhje në kuadër të menaxhimit të këtyre çështjeve e lidhur me funksionimin e sistemit CAMS. Duke marrë në konsideratë, se prokurori në cilësinë e drejtuesit, ushtron përveç detyrës së prokurorit të çështjes edhe detyrën e drejtuesit referuar kompetencave të tij si në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në atë të drejtimit administrativ të zyrës së prokurorisë, vlerësohet në drejtim të transparencës dhe garantimit të një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve, përcaktimi i disa kriterëve bazë që do të justifikonin reduktimin e ngarkesës së një drejtuesi, referuar numrit të kallëzimeve/referimeve penale që do të duhet të ndjekë e cila do të duhej të shoqërohej me akt të shkruar bazuar në procedurat e parashikuar në udhëzimin në fjalë për shpërndarjen e çështjeve. Gjithashtu në të njëjta konsiderata do të vlerësohej edhe reduktimi i ngarkesës së zv/drejtuesit të cilët në zyrat e prokurorive në fjalë, është konstatuar po ashtu i ulët.

Të dhënat tabelare elektronike të regjistrimit të kallëzimeve, si një nga burimet kryesore ku është mbështetur kryerja e inspektimit në disa prej zyrave të mëdha të inspektuara, përditësoheshin vazhdimisht kur bëheshin zëvendësime të prokurorit dhe si të tilla nuk mundësonin të dhënat fillestare të datës/emrit të prokurorit të caktuar për t'u vlerësuar në drejtim të shpërndarjes së çështjeve në një periudhë të caktuar.

Gjithashtu edhe lidhur me hedhjen e të dhënave elektronike lidhur me materialet me arrest në flagrancë/ndalim me iniciativë, nuk u evidentuan të dhëna mbi datën e arrestit/ndalimit, të dhënat këto të rëndësishme në drejtim të identifikimit të marrjes së materialit nga prokurori përkatës i gatshëm, në ato zyra që ndjekin praktikën e shpërndarjes duke marrë për bazë datën e arrestimit në flagrancë/ndalimi dhe prokurorin e gatshëm në datën përkatëse pavarësisht datës së hyrjes/protokollimit në prokurori.

- Në zyrën e apelit dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, bazuar në udhëzimin me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori" është konstatuar kryesisht ndjekja e rregullit të përgjithshëm të të proceduarit me anë të shortit për shpërndarjen e çështjeve.

Procedura e shortit e sipërpërmendur e zbatuar në këto zyra referuar udhëzimit me nr. 3/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori", ashtu si edhe në inspektimin e mëparshëm, është ajo e shortimit manual.

Në zyrën e apelit shorti manual është përdorur kryesisht për çështjet e themelit, ndërsa për masat e sigurimit kryesisht është proceduar sipas gatishmërisë.

Në Prokurorinë e Përgjithshme shpërndarja e çështjeve bëhej ndërmjet prokurorëve të Drejtorisë Gjyqësore dhe në rastet e mbingarkesës, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm shtoheshin edhe prokurorë të një drejtorie tjetër të të njëjtës zyrë prokurorie.

- **Në zyrën e Prokurorisë së Posaçme për shpërndarjen e çështjeve është proceduar me short manual dhe me caktim bazuar në nenin 15 pika 2, shkronja “b” e ligjit me nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.**

Prokuroria e Posaçme nuk është pjesë e “sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), por është duke punuar për një sistem që do të shërbejë në funksion të menaxhimit të çështjeve në zyrën në këtë zyrë.

## **V. Rekomandime**

### **Për prokuroritë subjekte të inspektimit:**

Raporti i inspektimit t’u njoftohet të gjitha prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, me qëllim njohjen me praktikën më të mira të identifikuar dhe problematikat e konstatuara lidhur me shpërndarjen e çështjeve në prokurori, si dhe të rregullimit të mënyrës së të proceduarit në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, referuar gjetjeve përkatëse sipas zyrave.

### **Për Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm**

Në regjistrin e pasqyrimit të të dhënave mbi njoftimet e gjykatave për përfaqësim, të pasqyrohet data e hyrjes në prokurori të njoftimit në fjalë dhe data e marrjes në dorëzim të këtij njoftimi nga prokurori i caktuar pas përfundimit të procedurës së shpërndarjes së çështjeve.

### **Për Prokurorin e Përgjithshëm**

Në përmbushje të kompetencave të parashikuara në ligjin organik, të vlerësohet rishikim i udhëzimit me nr. 3/2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” i ndryshuar, në drejtim: të përcaktimit edhe të çështjeve të tjera përveç kallëzimeve/referimeve penale që do t’i nënshtrohen rregullimit të procedurës së ndarjes me short, në konsideratat e ngritjes dhe zhvillimit të një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve; të rregullimit të shpërndarjes së çështjeve për të cilat mund të identifikohen se kanë të njëjtin fakt/apo lidhje me faktin e një kallëzimi tjetër të regjistruar më parë në prokurori dhe për të cilën është proceduar me caktim prokurori; të rregullimit të shpërndarjes së çështjeve për drejtuesit e prokurorive/zv/drejtuesin e zyrës/drejtuesin e seksionit mbi përcaktimin e kriterëve të mirëpërcaktuara mbi ngarkesën e punës në varësi të madhësisë së prokurorisë dhe ngarkesës së saj, referuar parashikimit në Kreun I, pika 5 të udhëzimit të lartpërmendur për shpërndarjen e çështjeve në prokurori;

Në funksion të inspektimit periodik të caktimit të çështjeve në prokurori, rekomandohet:

Vlerësimi i unifikimit të praktikës së ndjekur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm lidhur me mbajtjen e regjistrit elektronik në drejtim të evidentimit të datës së arrestimit në flagrancë/ndalimit me iniciativë.

Vlerësimi i unifikimit të praktikës së ndjekur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm lidhur me hedhjen e të dhënave elektronike në sistemin aktual deri në fillimin e funksionimit të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve, në drejtim të evidentimit të të gjitha çështjeve pavarësisht mënyrës së të proceduarit për shpërndarjen e tyre, si dhe datën e marrjes në dorëzim të çështjeve nga prokurori i caktuar.

#### **Për Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për t'u patur në konsideratë veprimtaria e prokurorëve, gjatë vlerësimit të punës së tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016.

#### **Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë**

Ndjekja në vazhdimësi e problematikës së evidentuar në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në drejtim të mos proceduarit me anë të shortit elektronik për të gjitha llojet e çështjeve.

Referuar gjetjeve në këtë raport, vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte të konstatuar në katër zyra prokurorie, që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit me nr. 96/2016. Për këto raste sipas një raporti të veçantë të përgatitur nga inspektori përkatës është sugjeruar:

- i. fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit me nr. 97/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për katër magjistratë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Vlorë dhe Berat.

#### **Propozime**

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar,

#### **PROPOZOJMË:**

1. Përfundimin e inspektimit tematik, datë 09.09.2025, të Prokurorive me objekt: "Mbi caktimin e çështjeve në Prokurori".



2. Caktimin e periudhës nga data 30.09.2025 deri në datën 30.12.2025, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohen prokuroritë subjekte të inspektimit: Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.
4. Të njoftohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Raportin e Inspektimit, duke i dërguar një kopje të këtij raporti.

### **INSPEKTORËT**

**Znj. Elena Pelushi**



**Znj. Lindita Ziguri**

